

Ibn Tejmijje

Xhinnet

Falënderimi i takon All-llahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë.

Kërkojmë strehim tek All-llahu prej të keqes të vetvetes dhe veprave tona të shëmtuara.

Kë udhëzon All-llahu s'ka kush e lajthit dhe kë e humb Ai, s'ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se përveç All-llahut,

Një dhe që nuk ka ortak, s'ka hyjni tjetër, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob i Tij dhe i Dërguar i Tij.

"O ju që besuat, kini frikë All-llahun me devotshmëri të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë" (Ali Imran: 102).

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe krijoi nga ajo të shoqen e saj, e prej atyre dyve shtoi burra shumë e gra.

Dhe kini frikë All-llahun në të cilin betoheni, dhe kini kujdes

akraballëkun, vërtet All-llahu është mbikëqyrës mbi ju" (Nisa: 1).

"O besimtarë, jini të devotshëm ndaj All-llahut dhe fjalë të drejta thuani.

Ai do ua bën veprat e juaja të mira, do ju shlyej juve mëkatet tuaja, e kush respekton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka korrë një fitore të madhe" (Ahزاب:70, 71).

• Kjo është hutbeja e emërtuar si 'Hutbetul-Haxhe', të cilën i Dërguari (;i) ua mësonte sahabëve (All-llahu qoftë i kënaqur me ta), dhe ata me këtë fillonin fjalimet e rastit, hutbet, këshillat etj."...dhe këtë e përforcon veprimi i të parëve të mirë, ku ata fillonin librat e tyre me këtë hutbe .. ". Albani, N. Hutbetul-Haxhe, fq. 31.(shënim R.R.)

Përgjigje me Citat

Hyrje

Derisa po shfletoj a disa materiale që i kisha tubuar për doktoratën time lidhur me pikëpamjen islame ndaj problemit të largimit të xhinëve, më ra në sy shqyrtimi: "Ideh ed-delaleh fi 'umum er-risaleh" (Seleksionimi i argumenteve në universalitetin e Shpalljes së peygamberëve. "), në blenin 19 të veprës Mexhmu' el-Fetava 1 nga Ibën Tejmijje dhe iu qasa përkthimit të saj.

Disa muaj më pas, gjatë kohës së hulumtimit në këtë fushë, kam hasur po këtë shqyrtim të shkruajtur në formë të broshurës² të cilën e kishte botuar Muhammed Shakir esh-Sharif bashkë me komentin e Ibën Tejmijjes të hadithit: ³ "Islami ka filluar në mënyrë të huaj (çuditshme)." ⁴ Pasi e lexova këtë trajtesë dhe pasi kuptova se më duhet ta përkthej pjesën më të madhe të saj për disertacionin tim, vendosa ta botoj dhe përkthej së bashku me disa fragmente nga bleni 35 i veprës Mexhmu el-fetava dhe klasikë s së Ibën Tejmijjes El-Furkan Bejne Evlija er-Rahman ve Evlija esh- Shejtan 5 të cilët kanë qenë në fusnotat e botimit të Muhammed

Shakirit.

Rëndësia e këtij përkthimi përkufizohet në faktin se kjo vepër, me sa e di unë, është vepra e parë e ofruar në gjuhën angleze, e cila ekskluzivisht ka të bëjë me temën e pushtimit të shpirtit (xhindosjes së shpirtit) dhe të përzënit e xhinnëve në Islam.

Tema e disertacionit tim të doktoratës është regjistruar në Yale University në Britaninë e Madhe.

Përpunimi i Ibën Tejmijes ofron pikëpamje shumë të qartë, koncize dhe autentike lidhur me këtë temë diskutabile, të bazuar në mësimet e Kur'anit dhe Sunnetit, si dhe komentimet dhe përvojat e sahabëve dhe dijetarëve të parë të Islamit.⁶

Vlen të theksohet se për hir të efikasitetit i kam ikur përkthimit të drejtpërdrejtë të tekstit origjinal duke synuar ta përshtati për lexuesin anglez. Fjalët dhe frazat që i kam shfrytëzuar nuk janë vendosur në pasus të njëjtë si në tekstin anglez (kjo ka të bëjë me tekstin origjinal arab - vër. e përkth.). Ia kam dhënë vetes të drejtën të eliminoj tema përcjellëse që janë transmetuar në mënyrë jo të qartë lidhur me këtë temë dhe të kombinoj artikujt e përsëritur në vendet ku kjo ide është përsëritur dy herë por në përmasa të ndryshme.

Intervenimet që i kam bërë në tekst, megjithatë përmbajnë rrjedhën autentike të idesë burimore të autorit dhe e bën tekstin të pranueshëm për lexuesin. Megjithatë, duhet pasur në mendje se idetë e paraqitura nga Ibën Tejmije paraqesin ide të jashtëzakonshme të shekullit XIV dhe kohës para tij, andaj unë kam shtuar një artikull të shkruajtur tani së voni në lidhje me temën e pushtimit të xhinnëve (xhindosjen) dhe përzënien e xhinnëve nga ana e njërit prej dijetarëve më të shquar të Arabisë Saudite, shejh bin Bazit i cili konfirmon qëndrimet e Ibën Tejmijes si burimore dhe të plotfuqishme.

Para përfundimit dëshiroj ta falënderoj vëllain Iftikar Mackeen-in për përpjekjet e tij të palodhshme në daktilografimin e manuskriptit njësoj si dhe për ndihmën e tij në përcaktimin e origjinës së haditheve që përmenden në tekst si dhe në fusnota.

Shpresoj që ky libër do të ndihmojë në largimin e mëdyshjeve ekzistuese dhe dilemave në mendjet e muslimanëve dhe jomuslimanëve lidhur me këtë temë vitale duke ofruar trajtim autentik islam në lidhje me këtë temë.

Ebu Amina Bilal Philips
Rijad, 18.12.1988.

(Ebu Amina Bilal Philips është lindur në Xhamajkë, por u rrit në Kanadë ku pranoi Fenë islame 1972.

Ai mbaroi kursin e gjuhës arabe në Medinë dhe vazhdoi studimet për të marrë titullin student i diplomuar i Fakultetit "Usulud-dijn" pranë

Univerzitetit të Medinës më 1979 dhe titullin magjistër i Teologjisë islame në Univerzitetin e Rijadit më 1985.

Ai ka dhënë ligjëratanga lëndët fetare islame dhe gjuha arabe në shkollën e mesme dhe të lartë të Rijadit gjatë viteve 1979-1987.

Veprat e autorit (përkthime): "The Dellil's Deception of the Shee'ah", "Khomeini: A Moderate or a Fanatic Shi-ite", "The Mirage in Iran", "Arabic Calligraphy in Manyscripts" dhe "Ibn Taymeeyah's Essay on Jinn". Autor i veprave: "Evolution of the Madh-habs, Tafseer Soorah al-Hujuraat", "The ansar Cult".)

1 'Abdur Rahman ibën Kasim el-'Asimi, Mexhmu 'fetava shejhul-Islam ibën Tejmije, (bejrut: Dar el-'Arebijja, botimi i parë, 1978).

2 Muhammed Shakir esh-Sharit (botues), Idah ed-dalaleh fi 'umum er'risaleh ve et-ta 'rit bi ahval el-xhin (Giza, Egjipt: Mekteba et-Tav'ija el-Islamija, botimi i parë, 1987).

3 Deklaratë e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e shënuar nga një ose më shumë sahabë.

4 Transmeton Ebu Hurejre, ndërsa e shënojnë Muslim dhe Ibën Maxhe.

Teksti i plotë i hadithit është: "Islami ka filluar në mënyrë të huaj dhe sërish do të bëhet i huaj, prandaj pritni me fjalë të mira të huajt." ('Abdul Hamid Siddiki, Sahihul-Muslim, vol. 1, fq. 86, nr. 270).

5 Abdullah Halim ibën Tejmije, El-Furkan Bejne Evlija er-Rahman ve Evlija esh-Shejtan, (Bejrut: el-Mekteba el-Islami, botimi i katërt, 1977).

6 Tema e vërtetë e këtij shqyrtimi është sqarimi i argumentit i cili dëshmon se porosia e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i është drejtuar njerëzve dhe xhinëve.

Megjithatë, duke bërë këtë, autori i qaset gjerësisht sjelljes dhe mendimeve të shejtanëve, xhinëve, pushtimit të xhinëve, përzënia e xhinëve, etj.

Njerëzit duhet të kuptojnë se All-llahu - i Madhërishmi dhe Lavdiploti - e ka dërguar Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për të gjitha botërat; botën e njerëzve dhe botën e xhinëve."

Të besuarit e All-llahut dhe të bindurit Atij është obligim i banorëve të dy botëve të përmendura.

Nga tërë gjinia njerëzore, edhe e xhinëve gjithashtu, kërkohet t'i përmbushin atë që All-llahu ka urdhëruar përmes Resulit të Tij, të çmojnë atë që e çmon All-llahu dhe i Dërguari i Tij, dhe të urrejnë atë që e urrejnë All-llahu dhe Resuli i Tij.

Është me rëndësi të përmendet se për çdo njeri dhe xhin është dhënë argumenti për shpalljen e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ai që nuk beson në këtë meriton të dënohet nga ana e All-llahut të Madhëruar, në mënyrën që është e ngjashme me ndëshkimet që i përjetojnë ata që nuk i janë bindur të dërguarve të mëhershëm.

Të besuarit që Pejgamberi Muhammed, sal-lall-llahu alejhi ve sel-

lem, është dërguar edhe për njerëzit edhe për xhinnët është parimi themelor i besimit me çka pajtohen sahabët, gjeneratat e besimtarëve të drejtë që kanë ardhur pas tyre dhe dijetarët kryesor të Islamit të të gjitha shkollave juridike -All-llahu qoftë i kënaqur me ata të gjithë.

Askush në asnjë grupacion islam nuk e mohon ekzistimin e xhinnëve dhe faktin që All-llahu e ka dërguar Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, edhe për ta.

Numri më i madh i jobesimtarëve, qofshin ata arabë paganë ose popuj tjerë semitë, "indusët" dhe të tjerët hamitë, shumica e kanaanitëve dhe grekëve¹⁰ dhe pasardhësve të tjerë të Jefetit¹¹, e konfirmojnë ekzistimin e xhinnëve.

Sa i përket fesë hebreje dhe krishtere, ata besojnë në ekzistimin e xhinnëve thuaja në mënyrë të njëjtë siç besojnë edhe muslimanët¹² ndonëse në mesin e tyre mund të ekzistojnë individë të cilët e mohojnë ekzistimin e xhinnëve. Individët të cilët e mohojnë ekzistimin e xhinnëve gjithashtu mund të hasen edhe ndër pjesëtarët e muslimanëve ortodoksë dhe sekteve muslimane siç janë xhahmitët¹³ dhe mu'tezilitët¹⁴ ndonëse numri më i madh i muslimanëve nuk e mohon ekzistimin e tyre.

Arsye e përhapjes së gjerë të besimit mbi ekzistimin e xhinnëve është të përmendurit e vazhdueshëm dhe konsistentë i ekzistimit të tyre në shpalljet e të dërguarve.

Ata janë përshkruajtur nga ana e gjithë të dërguarve si qenie të pavarura, të gjalla dhe inteligjente që posedojnë vullnet dhe janë objekte të ndalesave dhe lejrimeve, dho jo si aspekte të natyrës së njeriut siç pohojnë disa ateistë që e mohojnë ekzistimin e tyre.

Pasi që realiteti i xhinnëve është i përhershëm dhe i dëshmuar nga ana e pejgamberëve, është e njohur si për njerëzit e zakonshëm ashtu edhe për intelektualët.

Prandaj, vetëm një numër fare i vogël njerëzish e ka mohuar ekzistimin e melekëve, ringjalljes fizike nga vdekja, besimin në All-llah pa i përshkruajtur partner, dërgimin e pejgamberëve nga ana e All-llahut për njerëzit, etj. Këto argumente në tërësi janë përmendur në shpalljet e pejgamberëve dhe kanë qenë mirë të njohura edhe për njerëzit e zakonshëm edhe për parinë. Ato kanë qenë mirë të njohura në rrethana të ndryshme historike: të përmendim rastin kur Musai, alejhi-s-selam, kishte shkuar te Faraoni, fundosjen e Faraonit, ardhjen e Mesihut për hebrenjtë, armiqësia e tyre ndaj tij, paraqitja e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në Mekë, migrimi i tij në Medinë, interpretimi i tij i Kur'anit dhe ligjit, mrrekullitë të cilat i kishte prezentuar (si ajo e shtimit të ushqimit dhe pijes) dhe lajmërimi i tij për ngjarjet e kaluara dhe të ardhmet të cilat për asnjë njeri nuk mund të jenë të njohura pos përmes shpalljes së Lartësuar, etj.

Janë të njohura urdhrat e All-llahut për Pejgamberin e Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që t'u thotë politeistëve që t'i pyesin hebrenjtë dhe krishterët lidhur me gjërat që u janë shpallur vazhdimisht, e të cilat janë

theksuar në shumë ajete:

"Ne as para teje nuk dërguam tjetër, përveç burra, të cilëve u dhamë shpallje. Ju (idhujtarë) pyetni pra dijetarët (e Tevratit e të Inxhilit) nëse ju nuk dini." (Nahl:43)

Meqë ekzistojnë disa njerëz që e mohojnë se All-llahu e ka zgjedhur pejgamberë në mesin e njerëzve, All-llahu i lajmëron se të dërguarit që i ka dërguar Ai para Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kanë qenë njerëz dhe Ai u drejtohet jobesimtarëve duke i ftuar t'i pyesin hebrenjtë dhe krishterët që ta konfirmojnë këtë, nëse vërtetë nuk kanë frikë. Ngjashëm me këtë, atyre u jepet këshillë që t'i pyesin ata cilëve u janë shpallur Librat e lartësuar lidhur me njëjësinë e All-llahut dhe parimet tjera të misionit të pejgamberisë, e të cilat janë mohuar nga ana e jobesimtarëve. All-llahu i Gjithëpushtetshëm thotë:

"E ata që mohuan thonë: Ti nuk je i dërguar!" Thuaj: "Mjafton që Allllahu është dëshmitarë midis meje dhe midis jush dhe (është dëshmitar) ai që ka njohuri të librit (të shpalljeve)". (Ra'd: 43)

Po, (fjala vjen) nëse je në dyshim për këtë që të zbritëm ty (për ngjarjet e pejgamberëve), atëherë pyeti ata që lexojnë librin para teje. Ty të erdhi nga Zoti yt e vërteta, pra, mos u bë prej atyre që dyshojnë. (Junus: 94)

Thuaj: "Më tregoni mua se nëse ai (Kur'ani) është prej All-llahut, e ju e mohua (si do të jetë puna e juaj), ndërsa një dëshmitar nga beni israilët e dëshmoi si të tillë (të zbritur prej All-llahut) dhe i besoi, kurse ju bëtë, kryelartësi (a nuk jeni zullumqarë)?" E, s'ka dyshim se All-llahu një popull që është mizor, nuk e udhëzon në rrugën e shpëtimit. (Ahkaf: 10)

Kjo është e ndryshme nga informatat që janë të mirënjohura vetëm për dijetarët, si hadithet që flasin për pamjen e All-llahut (në Xhennet), të pyeturit në varr dhe sprovat e varrit, ndërmjetësimin (shefa'at), urën e Siratit (urë mbi zjarrin e Xhehennemit), dhe burimin (në Xhennet). Disa prej atyre që nuk kanë mjaft dituri ose që janë udhëzuar gabimisht, mund t'i mohojnë këto theksime, si për shembull grupet mu'tezilite: El-Xhaba'ija, Ebu Bekri el-Raziu dhe të tjerë të cilët e kanë pohuar ekzistimin e xhinnëve, por e kanë mohuar mundësinë e hyrjes së xhinnëve të trupin e njeriut dhe të pushtuarit e njeriut (xhindosjen). Qëndrimin e tillë e kanë arsyetuar me faktin se në hadithet e Pejgamberit,

sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, argumentet lidhur me ekzistimin e xhinnëve janë më të theksuar se aftësia e tyre për t'i pushtuar njerëzit (xhindosur njerëzit) j e që është, natyrisht, mendim i gabuar.
Prandaj, El-Ash'ari nga doktrina t e Ehli Sunetit ka përmendur se ata thonë: "Xhinnët mund të hyjnë në trupin e tyre që janë të sulmuar".
Në favor të këtij pohimitohet ajeti kur'anor:

Ata që e hanë kamatën nuk ngrehen ndryshe pos siç ngrehet i çmenduri nga të prekurit e djallit. (Bekare: 275)

Nga Abdullah ibën Hanbeli¹⁵ transmetohet: "Kur i kam treguar babait tim se dikush kishte pohuar se xhinët nuk mund të depërtojnë në trupin e njeriut, ai u përgjeggj: "Biri im i dashur, ai gënjen.
Ai është njëri prej tyre (shejtanëve) që flet me gjuhën e tij (shejtanit)."16
Ajetet që i janë shpallur Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i janë drejtuar të gjitha krijesave, si njerëzve ashtu edhe xhinëve, ngase porosia kur'anore i është drejtuar të gjitha botëve.
Kjo konsiderohet parim kryesor i shpalljes së Kur'anit, ndonëse shkaqet e shpalljes së disa ajeteve të caktuar mund t'i përshkruhen disa ngjarjeve që janë zhvilluar në mesin e arabëve të asaj kohe.
Asnjëri prej ajeteve nuk është i përkufizuar për nga natyra e vet në një shkas të caktuar të shpalljes së tij, e në harmoni me bashkëpëlqimin e dijetarëve islamë.
Disa dijetarë, megjithatë, nuk janë të një mendimi lidhur me atë a mund të jetë kategoria që ka të bëjë me shkakun e ajetit të jetë specifike për arabët për të cilët është shpallur ajeti i theksuar.
Sa i përket shkaqeve të posaçëm të shpalljes, nuk është e njohur që ndonjë musliman të ketë deklaruar, për shembull, që ajetet lidhur me shkurorëzimin, besatimin, ndëshkimin e hajnave dhe plaçkitëve etj., duhet të aplikohet vetëm tek ata njerëz, veprat e cilëve kanë qenë shkas i shpalljes së këtyre ajeteve.
Asnjë ligj hyjnor nuk është shpallur posaçërisht vetëm për arabët.
Në vend të kësaj, ligjet janë në emër të muslimanëve jobesimtarë, besimtarëve të vërtetë dhe atyre që shtiren në besimin e tyre, të singertët dhe hipokritët, të mirët dhe jo të mirët, etj., siç mund të hasim në Kur'an dhe hadith.
Megjithatë, një numër më i vogël dijetarësh ka pohuar që disa ligje kanë të bëjnë vetëm me arabët, mirëpo ata janë mbivotuar nga shumica.
Për shembull, Esh-Shafiu¹⁷ ka konstatuar se krejt ajo që konsiderohet e pamoralshme nga ana e arabëve është haram për të gjithë muslimanët, ndërsa
krejt ajo që ata e kanë konsideruar të mirë është hallall për të gjithë.¹⁸
Këtë mendim e kanë mohuar shumë dijetarë, si Maliku¹⁹, Ebu Hanife²⁰, Ahmedi dhe gjeneratat e mëhershme të ithtarëve të tyre.
Ndonëse El-Hajreki,²¹ bashkë me grupin ne dijetarëve të tjerë

hanbelitë,gjithashtu e ka përkrahur qëndrimin e Shafiut, numri më i madh i dijetarëve dhe sahabëve kanë konsideruar se ajo që është e lejuar dhe e ndaluar nuk është kushtëzuar me afinitetin e arabëve.

Në realitet, arabët i kanë preferuar gjërat të cilat All-llahu i ka ndaluar, siç është gjaku, shtazët e ngordhura,shtazët që kanë ngordhur si pasojë e ngulfatjes, ushqimit të tepërt, rënies ose goditjes, mbeturinat e shtazëve që i kanë naçetur egërsirat dhe shtazët që janë therrur në emër të dikujt tjetër dhe jo të All-llahut.

Mirëpo më i miri prej tyre (d.m.th. Pejgamberi) nuk ka preferuar madje edhe atë që nuk e ka ndaluar All-llahu.

Për shembull, mishi i zhapiut nuk i ka pëlqyer Pejgamberit tonë, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, prandaj me një rast kishte deklaruar:

"Nuk mund të gjendet në tokën e popullit tim, prandaj e kam mërzi."

Por kishte shtuar: "Vërtet ai nuk është haram".²² me një rast tjetër mishi i zhapiut ishte servuar në sofrën në të cilën ishte ulur edhe ai, me ç'rast kishte

deklaruar: "Unë nuk e ha, por as nuk e ndaloj."²³

Numri më i madh i dijetarëve konsideron se gjërat e mira të cilat All-llahu i ka lejuar janë ato që do ta shtojnë ibadetin e atij që i han, ndërsa të papastra janë ato që e dëmtojnë praktikën e tij fetare.

Drejtësia e përmban bazën e besimit të lartësuar të cilin All-llahu ua kishte dërguar të dërguarve të Tij për ta mëkëmbur.

All-llahu e ka ndaluar ushqimin i cili nxitë dhunë,vrazhdësi dhe egërsi.

Ai ka ndaluar të gjitha grabitçarët²⁴ ngase janë mizorë dhe të pamëshirshëm ngase ai që han është i ngjashëm me atë që e han.

Prandaj, nëse mishi i njeriut është prodhim i mishit të grabitçarit, te njeriu zhvillohen cilësitë instinktive grabitçare të agresivitetit dhe vrazhdësisë.

Mishi i derrit te njeriu prodhon karakteristika dhe cilësi më të prapa, meqë ushqehet me një spektër të gjerë të substancave nga çdo shtazë tjetër dhe

asgjë nuk e dëbon nga kjo.

Ngjashëm me këtë, gjaku përmban dhe transmeton fuqi të madhe seksuale dhe zemërimi që burojnë nga shpirti.

Nëse individi ushqehet prej tyre, dëshirat e tij dhe zemërimi shumë shpejt do të bëhen abnormale.

Si pasojë, vetëm gjaku i cili rrjedh është i ndaluar, ndërkaq që sasi të vogla siç është ajo që mbetet në enët e gjakut janë të lejuara, ngase nuk janë të dëmshme.

Aishja, radijall-llahu anha, thekson se ata e kishin zakon ta linin mishin në kazan dhe në të pastaj kanë hasur gjak.²⁵

Në bazë të kësaj që u tha, numri më i madh i dijetarëve e kanë përjashtuar sasinë e vogël të gjakut në trup apo rroba, me kusht që të mos rrjedhë." Ngase, nëse lejohet në ushqim, pa dyshim, duhet të lejohet edhe në rroba.

Është me rëndësi të theksohet se ndonëse arsyet e shpalljes së ajeteve të

caktuar kanë qenë ngjarje konkrete lidhur me jetën e arabëve të asaj kohe, ligjet të cilët këta ajete i sjellin janë gjithëpërfshirës, për të gjitha kohët dhe obligim për të gjithë muslimanët. Prandaj shpallja i është drejtuar si njerëzimit ashtu edhe xhinnëve ndonëse pjesa më e madhe e saj nuk është shpallur si pasojë e ngjarjeve që kanë ndodhur ndërmjet njerëzve.

7 Xhinnët janë krijesa që janë sajuar me vullnet të lirë, jetojnë në Tokë në botën e cila është paralele me jetën e njerëzve, dhe janë të padukshëm për syrin e njeriut derisa janë në gjendjen e tyre normale.

Fjala arabe xhinn vie nga falja xhenna që do të thotë fshehem.

Prandaj, embrioni në bark quhet xhanin, ndërsa zemra në gjoks quhet xhenan. Shprehja xhinni është ekuivalent i xhinn, ndërsa xhaan mund të shfrytëzohet si në formë të njëjësit ashtu edhe në shumës.

Në literaturën islame Shejtani është emërtim për xhinnët jobesimtarë (shih Fet'hul Bari nga Ahmed ibën Ali ibën Hixhri; Kajro, Egjipt: el-Metba'a es-Salefijah, botimi parë, 1961, val. 6, fq. 344 dhe val. 8, tq. 675).

Ata janë krijuar nga zjarri, në pajtim me deklarin e All-llahut në Kur'an: E xhinnët i krijuam më parë nga zjarri, nga flaka e fortë. (Kur'an, 15:27).

Ata nuk janë "engjëjt të rënë".

Nga Aishja, radijall-llahu anha, transmetohet që Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të ketë deklaruar: "Melekët janë krijuar nga drita, ndërsa xhinnët nga zjarri." (Sahih Muslim, val. 4, fq. 1540, nr. 7134).

Melekët gjithashtu nuk mund të jenë të padëgjueshëm ndaj All-llahut, në pajtim me deklarin e All-llahut në Kur'an: ... Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar. (Kur'an, 66:6).

8 Në besimin e Mesopotamisë në mesin e asirasve dhe babilonasve të lashtë kanë ekzistuar dy lloje demonësh: me natyrë jonjerëzore dhe hakmarrës të vdekjes.

Në kuadër të llojit të parë mund të dallohen disa tipe: ata që fshihen në vende të rrezikshme, do të thotë në vende të shkreta dhe varreza - Lambartu, demonët femëror të maleve dhe kënetave të cilët në veçanti i sulmojnë fëmijët.

Sedu dhe Lamassu kanë qenë të ndarë, duke qenë shpirtra të këqij dhe shpirtra ruajtës.

Lilitu ka qenë demon femër i cili bën marrëdhënie seksuale me meshkujt e fjetur.

Etimmu kanë qenë shpirtrat e atyre që kanë vdekur në fatkeqësi dhe të cilët janë frikuar shumë.

Sëmundja dhe fatkeqësia i janë përshkruajtur sulmeve të demonëve, në veçanti Etimmu. (S.G. Brandon, gen. ed. A Dictionary of Comparative Religion, London: Veinfild&Nicolson, botimi dytë, 1971, fq. 232).

9 Në mesin e indusëve demonët kanë qenë si me origjinë njerëzore ashtu edhe me origjinë jashtënjerëzore: a) shpirtrat jashtënjerëzor ose miqtë janë udhëhequr me aftësi jashtënjerëzore, ndërsa posedojnë trup material llojesh të ndryshëm të cilët mund të ndryshojnë, e që janë objekt i shkatërrimit.

Si agensa të lirë, ata mund të zgjedhin ndërmjet të mirës dhe të keqes, mirëpo animi kah e keqja dominon në karakterin e tyre. Asuras, Danavas, Dajtias dhe Raksasas i përaksin këtij grupi. b) Shpirtrat njerëzor, ose shpirtrat e qenieve njerëzore, të njohur përgjithësisht si Bhuta janë gjithnjë të prapë.

Ata formohen nga shpirtrat e atyre që kanë vdekur para kohe ose më dhunë, ose janë deformuar, idiotët dhe të marrët; ata që kanë pasur shtangime ose vuajtje të jashtëzakonshme: ose të dehurit, të shfrenuarit dhe të magjiosurit gjatë jetës.

Më të rrezikshmit prej të gjithëve janë shpirtrat e të vrarëve, atyre që e kanë braktisur këtë botë pa përmbushjen e dëshirave dhe shpirtrat e të huajve. (James Hastings, Encyclopedia of Religion dhe Ethics, Edunburgh: T. and T. Clark, botimi i katërt, 1959, vol. 4, fq. 601- 603).

10 Fjala angleze "demon" është nxjerrur nga fjala greke "daimon", pl. "daimones".

Poeti grek nga shekulli VIII para erës sonë, Hesiodi, në verpën e tij Mbi katër stinët, sqaron se pas vdekjes, ata të moshës së artë bëhen deimones (Vorks and Deys, fq. 1099).

Ata janë përshkruar si rojtarë të njerëve, ndarës të pasurisë dhe pronës, por janë ndërthurrur në errësirë ashtu që janë të padukshëm derisa shtegtojnë

nëpër çdo vis të Tokës.

Përderisa ndaj tyre sillemi me respekt, prej tyre pritet të jenë në shërbim. Këta janë demonët e mirë. Shpirtrat e këqij janë përshkruar si shpirtra të heronjve për të cilët është konsideruar se janë të paaftë që të fitojnë bekimin dhe janë të aftë vetëm për keq.

Disa demona të këqij janë paraqitur se janë posaçërisht të lidhur për disa individë prej lindjes së tyre deri në vdekje.

Të tjerët janë përjetuar si demonë hakmarrës dhe kanë qenë instrument i dënimit të krimit të familjeve të caktuara dhe janë quajtur më emër të posaçëm Alastor (Encyclopedia of Religion and Ethics, vol. 4, fq. 590-593).

11 Biri i Nuhut, [alejhis-selam], i cili është përmendur në Genesisi 5:32. Nga jefet hebrej që nënkupton shtim (Jess Stein ed., The Random House Dikctionary, Nev York: random House, 1966, fq. 763).

12 Në literaturën paraegziliane hebreje demonët janë përshkruajtur si qenie identike me xhinnët.

Për shembull, në Isaije 34:14 është sajuar një shënim mbi Se'irimin, d.m.th. leshtaorët, e që është përkthyer në botimin e plotësuar standard të Biblës si Satirët, që kanë qenë demonë të këqij, ndërsa janë vendosur

nëpër rrënoja.

Pas dëbimit, shënimi për demonët haste në Genesis, 6:2-4, ku janë paraqitur si melekë të dëbuar.

Krishterimi e ka trashëguar demagogjinë e Dhiatës së Vjetër.

Personalitetet prijëse (Toma Akuini, vdiq 1274.) e kanë pranuar qëndrimin se demonët janë melekë të dëbuar, të privuar nga statusi i privilegjuar fillestar për shkak të krenarisë dhe lakmisë.

Ata banojnë si në Xhehennem, ku janë dënuar me mallkim, ashtu edhe në ajr ku u shkaktojnë vuajtje njerëzve.

Literatura apokrifike si vepra Apocalypses nga Peteri dhe Pauli dhe Coptic History nga Joseph Carpenter i përshkruan demonët dhe veprimet e tyre.

(A dictionary of Comparative Religion, fq. 230-1).

13 Themeluesi i kësaj shkolle teologjike, Xhahm ibën Safvani (vdiq 745) i ka mohuar të gjitha atributet e All-llahut, pos se është i Gjithëfuqishëm dhe Krijues.

Ai gjithashtu ka pohuar se derisa individ i beson këtë, veprat e këqija nuk mund t'i shkaktojnë dëm as ai do të dënohet për to.

Ai më tej ka inicuar një formë ekstreme të krahasimit, e ka mohuar vullnetin e lirë dhe ka pohuar se Xhenneti dhe Xhehennemi nuk janë të përietshëm. Ithtarët e tij, të quajtur Xhemije kanë jetuar deri në shekullin XI në rrethinën e

qytetit Tirmid por më pas i kanë përvetësuar doktrinat e shkollave më të njohura teologjike të kohës, atë të Ash'aritëve.

14 Kjo shkollë është themeluar në shekullin VIII nga ana e Vasil ibën 'Attait dhe 'Amr ibën 'Ubejdit, ish studentëve të Hasan el-Basriut, radijall-llahu anhu. Është bazuar në doktrinën e gjendjes së ndërmjeme në mes besimit dhe mosbesimit në të cilën besimtari bie kur bën një mëkat të madh.

Doktrina e vullnetit të lirë është shtuar duke pasur parasysh krahasimin e xhehmitëve, bashkë me mohimin e attributeve të All-llahut të cilët ata i kanë marrur në formë paksa të ndryshuar nga doktrina xhehmite.

Teologët e pastajmë të kësaj shkolle e kanë shtuar doktrinën hindu-krishtere të pranisë së gjithëmbarshme të All-llahut që All-llahu është i pranishëm gjithkund.

Doktrinat mu'tezilite janë bërë themel i teologjisë zyrtare të kalifatit 'Abasid i cili mbi 100 vjet e ka përhapur me dhunë në të gjitha viset e botës islame deri në shekullin XII.

Në fund ka mbijetur si bazë e teologjisë Shiite në mesin e Dymbëdhjetëve (Ithnaa 'Asharija) dhe Zejdive.

Disa prej doktrinave të tyre edhe sot janë të pranishme ndër muslimanë. (Shorter Encyclopedia of Islam, fq. 421-426).

15 Ahmed ibën Muhammed ibën Hanbeli është lindur në Bagdad në vitin 780 dhe ka udhëtuar shpesh në Irak, Siri, Hixhaz, Arabinë Perëndimore dhe Jemen duke tubuar hadithe.

Pasi që është kthyer në shtëpi, studjon fikhun (e drejta islame) te imam

Shafiu.

Në kohën e sundimit të kalifëve abbasidë El-Me'munit (813-833), El-Mu'tesimit (833-842) dhe El-Vatikut (842-847) dogma mu'tezilite është bërë doktrinë

zyrtare shtetërore dhe për ta vendosur atë ishin themeluar gjyqe të rrepta. Ibën Hanbeli ka mohuar haptas konceptet filozofike pagane greke mbi të cilat ishte bazuar doktrina mu'tezilite për ç'arsye më pas është arrestuar dhe keqtrajtuar fizikisht.

Në kohën e kalifit Mutevekilit (847-861) është mbajtur gjykimi ndaj Ibën Hanbelit, ndërsa fama mbi mësimin e Ibën Hanbelit, devotshmërinë e tij dhe besimin e paluhatshëm në traditë kishte tubuar shumë studentë dhe ithtarë rreth tij.

Vdes në Bagdad në vitin 855, ndërsa në themelet e doktrinës së tij është themeluar shkolla hanbeliane juridike.

Vepra e tij kryesore, El-Musned përmban afërsisht rreth 4 mijë hadithe (H.A.R. Gibbs and J.H. Kramer, Shorter Encyclopedia of Islam, Ithaca, New York: Cornell University Press, 1953, fq. 20-22.)

16 Muhammd ibën 'Abdullah esh'Shibli, Ahkam el-Xhaan, Bejrut: Dar Ibn Zejdun, botimi parë, fq. 143-144.)

17 Muhammed ibën Idris esh-Shafi'u është lindur në Gaza në vitin 676, ndërsa është rritur në Mekë, ku e ka mësuar hadithin dhe fikhun dhe ka mësuar përmbledhjen e hadithit Muvetta (nga imam Maliku) në tërësi.

Në moshën 20 vjeçare shkon në Medinë ku mëson te imam Maliku deri në vdekjen e tij në vitin 796.

Pastaj mëson nga nxënësit e imamet, Ebu Hanife në Irak, Muhammed ibën el-Hasan esh-Shiblit dhe Ebu Jusufit, njësoj si edhe prej nxënësve të imam El-Lejzi ibën Sa'dit (716-799) në Egjipt.

Atij i përshkruhet themelimi i shkencës juridike në islam Usul el-Fikh, të cilën e ka përpunuar në veprën e tij Er-Risala (Mexhid Hadduri, Risala e Shafi'ut, Cambridge, UK: The Islamic Texts Society, botimi dytë, 1987). Megjithatë, vepra e tij kryesore nga fusha e jurisprudencës islame mban titullin Kitab el-Umm.

Vdes në Fustat, të Egjiptit, në vitin 820, ndërsa në bazë të mësimave të tij është themeluar shkolla shafiite juridike.

18 Kjo rregull është bazuar në ajetin "u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet" (Kur'an, 7:157).

Pasi ajo që konsiderohet e mirë dhe ajo imorale mund të dallohen varësisht nga kultura, Esh-Shafi'u kishte vendosur rregullën sipas cilës shijet e arabëve do të duhej të shfrytëzohen si kriter pasi që ky ajet u është shpallur atyre para se dikuj tjetër.

19 Malik ibën Enesi i lindur në vitin 713 në Medinë, ku është rritur duke mësuar hadithet nga dijetarët e atjeshëm.

Imam Maliku më pas është bërë dijetari kryesor i kësaj fushe dhe nga ana e mëkëmbësit abbasid në Medinë, Xha'fer ibën Sulejmani është arrestuar dhe kamxhikosur tmerrësisht për shkak të deklaramit të fetvasë kundër

politikës së kalifit Mensur (vdiq 775).

Imam Maliku ka sajuar veprën më të hershme të haditheve që ka arritur deri te ne me titull "El-Muvetta" të cilët e kishte sajuar afërsisht dyzet vjet. Studentë nga mbarë bota islame kanë mësuar prej saj, ndërsa si rezultat i kësaj sot ekzistojnë rreth gjashtëmbëdhjetë versione të ndryshëm të saj. Më autentikja prej tyre është libri të cilën e ka sajuar nxënësi i Malikut, spanjoli Jahja ibën Jahja-a (vdiq 848).

Kjo shkollë juridike është zhvilluar në Medinë, ndërsa më vonë është quajtur sipas themeluesit të saj: shkolla malikije juridike. (Shorter Encuclopedia of IIsma, fq. 320-324).

20 Ebu Hanife en-Nu'man ibën Thabit, është lindur në Kufë në vitin 700. Ka jetuar duke punuar si tregtar por tërë jetën ia ka kushtuar mësimin dhe studimit të Islamit.

Ebu Hanife e kishte takuar sahabin Enesin, radijall-llahu anhu, si dhe kishte studjuar hadith te dijetari i madh i hadithit Hammad ibën Zejdi plot tetëmbëdhjetë vjet.

Ka refuzuar ta pranojë vendin e kadiut kryesor përkundër instistimit të mëkëmbësit emevit të Kufës Jezid ibën Omerit, më vonë edhe kalifit El-Mensuri (754-775), për ta pranuar këtë.

Duke refuzuar këtë, kishte përjetuar keqtrajtim fizik dhe arrestim e që kishte rezultuar me vdekjen e tij në burg në vitin 767.

Rregullat e tij dhe pikëpamjet janë bashkuar në shkolën hanefije të jurisprudencës islame.

21 Omer ibën Husejn el-Hajreki (vdiq 945) ishte jurist hanbelit nga Bagdadi. (El-A'lam, vol. 5, tq. 44).

22 Sahih Muslim, vol. 3, tq. 1074, nr. 4790.

23 Ibid., vol. 3, tq. 1073, nr. 4784.

24 Hiena është përjashtuar nga ndalesa e shtazëve grabitçare në bazë të deklaramit të Xhabir ibën 'Abdullahut: "E kam pyetur Resulull-llahun lidhur me hienën, ndërsa ai më është pergjegjur: 'Kjo është lojë, dhe nëse individ i cili e zë derisa është ende në ihrame, duhet ta japë një dele për kompensim'."

E transmetojnë Ebu Davudi (Sunen Ebu Davud, vol. 3, tq. 1071, nr. 3792), Ed-Darimi, El-Bejheki, Ibën Hibbani, Ed-Darakutni dhe El-Hakimi, dhe në Sahih nga Hakimi e El-Albani (shih Irva el-Galil, vol. 1, tq. 242, nr. 1050).

Ekzistojnë edhe shumë versione tjera që e konfirmojnë këtë që u tha, ndërsa i kanë shënuar: Tirmidhi, Nesa'i, Ibën Maxhe dhe Ahmedi.

Shumë nxënës, përfshirë këtu edhe Ebu Hanifen, Malikun dhe Eth-Thevrin e kanë ndaluar ngrënien e hienës në bazë të hadithit të cilin e transmeton Ibën

'Abbasi, radijall-llahu anhu, e ku thuhet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka ndaluar ngrënien e shtazëve grabitçare me dhëmbë të gjatë dhe të gjitha shpezëve me kthetra. (Shih Sunenin e Ebu Davudit, vol. 3, tq. 1071, nr. 3794 dhe 3796).

Ata gjithashtu kanë theksuar hadithin i cili është cituar nga Tirmidhi, kurse e transmeton Huzejma ibën Xhuz'ini: "E kam pyetur Resulull-llahun, sal-lall-llahu

alejhi ve sel-lem, lidhur me hienën, kurse ai më është përgjegjur: "A e han kush hienën?" Megjithatë ky version i fundit është da'it dhe version i mëparmë të cilën e transmeton Xhabiri përmban ndalesën e përgjithshme ku bën pjesë edhe hiena.

Në realitet, pos Shafiut dhe Ahmedit, Ibën 'Abbasi, i cili e kishte theksuar këtë ndalesë të përgjithshme, personalisht e ka lejuar ngrënien e hienës. Ibën el-Kaliim në veprën 'l'am el-Muki'in ka deklaruar: "Në sheriat nuk ka asnjë rast të përjashtimit nga rregulla për diç që është e ngjashme për nga të gjitha aspektet e veta.

Për atë që persiatë për fjalët e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, do të jetë e qartë që ai ka ndaluar mishin e shtazëve të cilat i posedojnë dy

cilësi: kthetrat dhe natyrën e grabitçarit, si luani, pantera, tigri, ujku.

Hiena, nga ana tjetër, ka vetëm njërin nga këto cilësi edhe ato janë kthetrat, mirëpo nuk është grabitçare për nga natyra e saj.

Nuk ka dyshim se natyra grabitçare është më e rëndësishme se posedimi i kthetrave.

Grabitçarët janë të ndaluar për shkak të natyrës së tyre agresive të cilën individi i cili do ta hante mishin e tyre pa dyshim do ta fitonte në masë të caktuar.

Është evidente që instinkti grabitçar të cilin e hasim te ujku, luani, tigri apo pantera nuk është i pranishëm te hiena në atë masë e cila do të ishte e mjaftueshme për llogaritjen e saj në këtë kategori.

Hiena nuk konsiderohet grabitçare si për nga definicioni linguistik ashtu edhe për nga zakoni." (Muhammed el-Edhem Ibadi, 'Avn el-Ma'bud Sharh Sunen Ebu Davud, Kairo: El-Mektebah es-Selefijja Midinah, botimi dytë, 1969, vol. 10, fq. 275-276).

Thënë shkencërisht: "...hiena është e njohur si kërmëngrënës.

Ajo ka shqisë të fortë të të nuhaturit dhe mund ta njohë erën e shtazës së vdekur nga një largësi e madhe.

Hiena gjithashtu i përcjell kërmëngrënësit të cilët do ta dërgojnë deri te ndonjë shtazë e ngordhur apo që po ngordhë...

Përqindja më e madhe e ushqimit të saj vie nga shtaza të cilën e ka mbytur luani...

Ajo shpesh i ndjek kopetë e mëdha të shtazëve në kontinentin afrikan dhe ushqehet me kërmë, shtazë të sëmura dhe të dobësuar, të cilat nuk mund të ikin.

Hiena me lara e Indisë e cila ishte endur nëpër hapësirat e Palestinës, Arabisë dhe Afrikës së Veriut... plotëson ushqimin e saj të kërmëngrënësit duke gjuajtur kopetë e deleve dhe dhive.

Nganjëherë ndodhë të sulmojë edhe bagëtinë e vogël.

Në realitet, mishi i hienës është i ëmbël dhe i shijshëm, ndërsa zakonisht

e konsumojnë shtresat e varfëra të shoqërisë në Afrikën e Jugut.
Era e trupit të saj është mjaftë i mirë në krahasim me atë të dhelpërës dhe
çakalli!." (Botimi i Viliam D. Hasley, Collier's Encyclopedia, SHBA: Corvell-
Gollier

Educational Corporation, 1970, vol.2, fq. 439-440).

25 Ibën Xheriri ka përmendur këtë traditë (rrëfim) në tefsirin e tij, ndërsa
Ibën Kethiri e ka përshkruar si Sahih Garib (autentik, por i
jashtëzakonshëm).

26 Do të thotë, sasi të vogël të gjakut në trup, sipas mendimit të tyre, nuk
do ta prishë abdestin, derisa është e tharë ose të paktën derisa të mos
njedhë.

Mejgithatë, ekziston dëshmi e qartë nga hadithe autentike të cilët
dëshmojnë se gjaku që njedh nuk e prishë abdestin. (Sahih Buhariu, vol.1,
fq. 121, nr.

35 dhe fq. 150, nr. 73).

Numri më i madh i njerëzve në të gjithë popujt pranon ekzistimin e xhinnëve në bazë të përvojave të cilat do të merrnin kohë të gjatë duke i përshkruar këtu.

Politeistët shfrytëzojnë talismanë dhe recitativë që përbëjnë në vete madhërim dhe adhurim të xhinnëve, dhe numri më i madh i magjive, talismanëve dhe recitativëve që janë në përdorim në mjediset muslimane në vete përbëjnë shirk (të përshkruarit shok All-llahut) përmes xhinnëve.

Si pasojë e kësaj, dijetarët islamë e kanë ndaluar përdorimin e magjisë, domethënie të cilës nuk janë të qarta, ngase ekziston mundësia e devijimit në shirk, madje edhe nëse magjia, vetvetiu, nuk përmban shirk.

Në Sahih Muslim ekziston një version të cilën e transmeton 'Avf ibën Malik el-Ashja'i në të cilën thuhet: "E kishim zakon të bënim magji në kohën e jobesimtarisë sonë, andaj deklaruar: 'O Resulull-llah, cili është mendimi yt në këtë aspekt?'

Ai u përgjigj: 'Ejani të dëgjoj magjitë tuaja, ngase ato magji të cilat në vete nuk përmbajnë shirk janë të lejuara.'²⁷

Në Muslim gjithashtu ndodhet edhe një transmetim të cilin e shënon Xhabiri, e në të cilën thuhet:

"Kur Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e kishte ndaluar magjinë, familja e 'Amr ibën Hazmit kishte ardhur te Pejgamberi dhe i kishte thënë:

'O Resulull-llah! Kemi bërë magji për therrjet e akrepit, ndërsa tani ti i ke ndaluar magjitë.'

Ata ia recituan, kurse ai u tha: Kjo është në rregull.

Cili prej jush ka mundësi t'i ndihmojë vëllait duhet ta bëjë këtë,."28

Vetëm një grup i vogël i filozofëve, mjekëve të paarsimuar e kanë mohuar ekzistimin e xhinnëve.²⁹

Sa i përket numrit më të madh të dijetarëve, është shënuar që ata e kanë vërtetuar ekzistimin e xhinnëve ose nuk kanë thënë asgjë për këtë.

Është e ditur se Hipokrati në aspektin e pijeve të caktuara ka deklaruar "Janë të dobishëm për shtangie. Nuk e kam fjalën për tipet që shërohen nga klerikët fetarë, por e kam fjalën për shtangimet që i shërojnë mjekët."³⁰

Ai gjithashtu ka deklaruar: "Mjekësia jonë në krahasim me mjekësinë e klerikëve fetarë është si mjekësia e plakave në krahasim me mjekësinë tonë."

Ata që e mohojnë ekzistimin e xhinnëve nuk kanë argumente me të cilët do të konfirmonin mohimin e tyre.

Ata kanë vetëm mungesë të diturisë, ngase besimi dhe dituria eksperimentale e profesionit të tyre nuk përmbajnë asgjë që do të konfirmonin ekzistimin e xhinnëve.

I tillë është rasti i mjekut i cili interesohet për shëndetin e trupit ashtu që shëron simptomët fizike të sëmundjes nga pikëpamja e ndryshimeve në

fushën fizike, pa shqyrtim të asaj që mund t'i ndodhë trupit në aspektin shpirtëror ose asaj që do të mund t'i ndodhë trupit si pasojë e veprimit të xhinnit. Ky është rast i shpeshtë, ndonëse mjeku e din, të paktën nga ajo që ka mësuar në disiplinat tjera shkencore, pos mjeksisë, që shpirti ka ndikim më të madh në trup se vetë medikamentet."

Xhinni me siguri ka ndikim të caktuar te njerëzit në bazë të deklaramit të qartë të Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e cila është transmetuar me besnikëri: "Vërtet shejtani qarkullon në birin e Ademit ashtu siç qarkullon gjaku. "32

Njëri prej përbërësve të gjakut të njeriut është edhe eteri, për mjekët i njohur si "shpirti shtazarak" të cilin e dërgon zemra dhe cili qarkullon nëpër trup duke i dhënë jetë.³³

Fakti që Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i është dërguar njerëzimit si edhe xhinnëve mund të haset edhe në Kur'an, ku All-llahu përmend grupin e xhinnëve të cilët e kanë dëgjuar Kur'anit dhe kanë besuar në të.

All-llahu i drejtohet Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me fjalët:

(Përkujto) Kur disa prej exhinnëve i drejtuam te ti që të dëgjojnë Kur'anin dhe kur u afruan dhe e dëgjuan atë, thanë: "Heshtni!" dhe kur u krye, u kthyen te populli i vet dhe e këshilluan.

Thanë: "O populli ynë, në dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, që udhëzon në të vërtetën dhe në rrugën drejtë!" O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të All-llahut dhe besoni atij! Ai ju falë mëkatet tuaja dhe ju shpëton prej një dënimi plot vuajtje.

E kush nuk i përgjigjet atij që thërret në rrugën e All-llahut, ai nuk është i pamposhtur në tokë dhe pos Atij, ai nuk ka mbrojtës, të tillët janë në një humbje të hapët!" (Ahkaf: 29-32)

Ai pastaj i kishte urdhëruar t'i lajmëroj të gjithë njerëzit:

Thuaj: "Mua më shpalllet se një grup i vogël nga xhinnët i vuri veshin dhe dëgjoi (Kur'anin) dhe (kur u kthyen te të vetët) thanë: "Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij dhe Zotit tonë, kurrsesi nuk do t'ia shoqërojmë më askë" Dhe se lartësia e madhëruar e Zotit tonë, nuk është që ka as grua, as fëmijë.

S'ka dyshim se ai mendjelehti jonë fliste të pavërteta ndaj All-llahut.

Ndërsa, ne kemi pas menduar se as njerëzit, as xhinnët nuk flasin gënjeshtër përkitazi me All-llahu. (Xhinn: 1-5)

Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i është urdhëruar t'i lajmërojë njerëzit për botën e xhinnëve dhe t'u tregojë atyre se i është dërguar njerëzve dhe xhinnëve si udhërrëfyes për t'i udhëzuar në atë që kërkohet prej tyre në pikëpamje të besimit në All-llahun, peygamberët e Tij, Ditën e Gjykimit dhe bindjes ndaj peygamberëve.

Urdhri gjithashtu është shprehur në pikëpamje të ndalimit të shirkut me

xhinnët ose të tjerët, siç thotë All-llahut:

Dhe se ka pasur burra prej njerezve,qe kerkonin ndihmë prej disa xhinnëve dhe ashtu ua shtonin atyre edhe më shumë arrogancën. (Xhinn: 6)

Sa herë që ndonjë njeri në atë kohë hynte në ndonjë luginë - ndërkaq që luginat konsideroheshin vendbanime të xhinnëve, ngase me shpesh i vizitonin

luginat se viset kodrinore - njeriu deklaronte:"Kërkoj strehim te zoti suprem i kësaj luginë nga banorët e tij të pakujdesshëm."

Kur xhinnët i gjenin njerëzit duke kërkuar strehë tek ata, ata i terrorizon in njerëzit dhe i sulmonin me ashpërsi edhe më të madhe.

Njerëzit me vete bartnin hajmali dhe talismane duke përdorur emrat e xhinnëve dhe sundimtarëve të tyre dhe ata betoheshin me emrat e atyre nga mesi i xhinnëve dhe sundimtarëve të tyre të cilët i nderonin.

Kjo kishte si pasojë atë që njerëzit tregonin më shumë respekt dhe nderime për xhinnët se vetë njerëzve.

Xhinnët shpesh i plotësonin disa kërkesa të njerëzve, posaçërisht ngase kanë ditur që njeriu është më i pastër dhe më i ndershëm se vetë ata.

Nëse njeriu i nënshtrohet atyre dhe kërkon strehim tek ata, ai bëhet i ngjashëm me një person të rëndësishëm, i cili kërkon ndihmë nga ai që nuk është i denjë për përmbushjen e dëshirave të tij.

Shejtanët nga mesi i xhinnëve janë ata që e kanë zgjedhur mosbesimin, idhujtarinë dhe mosbindjen ndaj Zotit të vet.

Iblisi" dhe ushtria e tij e shejtanëve dëshirojnë prapësi, kënaqen me të dhe e kërkojnë me makutëri për shkak të zvetënimit të shpirtit të tyre.

Ata do të vazhdojnë ta bëjnë këtë, ndonëse e dijnë se do të ndëshkohen bashkë me ata që i kanë larguar nga rruga e drejtë.

All-llahu thekson se Iblisi i ka deklaruar këto fjalë:

Ai tha:"Pasha madhërinë Tënde,kam për t'i shmangur prej rrugës së drejtë që të gjithë, përveç atyre që janë të sinqertë nga robërit e Tu!" (Sad:82,83) (mandej vazhdoi e) tha:

"A e sheh (i tha Zotit) këtë që Ti e vlerësove mbi mua, nëse më lë të jetojë deri në ditën e kijametit, unë gjithsesi do t'i shfaros pasardhësit e tij, më përjashtim të një pakice". (Isra: 62)

All-llahu ka vërtetuar se shejtani do të arrijë sukses:

Në të vërtetë, djalli realizoi mendimin e vet ndaj tyre, ndaj edhe e dëgjuan atë, përpos një grupi besimtarësh. (Sebe: 20)

Nëse shpirti i njeriut prishet, natyra e tij pastaj do ta dëshirojë atë që është e dëmshme dhe ai do të kënaqet në prapësi të cilën do ta adhurojë me

çdo kusht.

Si pasojë e kësaj, karakteri, shëndeti dhe pasuria i njeriut të tillë gjithashtu do të prishen dhe të shkatërrohen.

Vetë shejtani është i keq, andaj nëse individ i kërkon të arrijë diç përmes gjërave që i do, siç është magjia, betimi, librat spirituale, mosbesimi dhe idhujtaria etj., ai do të plotësojë disa nga dëshirat individuale.³⁵

Veprat jashtëfetare janë si mito e shejtanit.

Kjo është e ngjashme me rastin kur një njeri i ofron një tjetrit para për ta vrarë dikë që dëshiron ta vrasë ose t'i ndihmojë atij në kryerjen e veprës së paturpshme.

Prandaj shumë shkrime përmbajnë ajete kur'anor të shkruajtur në papastërti si gjaku, e të ngjashme, ose disa fjalë kur'anore të shënuara mbrapsht, ose gjëra të tjera që e kënaqin shejtanin shkruhen ose deklarohen sipër tyre.

Kur ajo që e kënaqë shejtanin shkruhet ose deklarohet nga ana e njerëzve, ai mund t'u ndihmojë në realizimin e disa dëshirave, për shembull, të largojë sasi të mëdha të ujit nga një vend në tjetrin, ose t'i zhvendosë prej një vendi në një vend tjetër nëpër ajr, ose t'u sjellë pasuri haram të atyre që nuk e përmendin emrin e All-llahut, i fituar me mashtrime, vjedhje etj. Me të vërtetë di shumë raste të ndryshme që kanë ndodhur në raport me ngjarjet e mëparshme që janë përmendur dhe shënimi i tyre do të merrte shumë vend - pasi që raste të tillë ka pa numër. Është me rëndësi të përmendet që All-llahu ka thënë se Muhammedi, sal-lall llahu alejhi ve sel-lem, është dërguar si pejgamber për të dy botërat, ndërsa

xhinnët e kanë dëgjuar mësimin e Tij në Kur'an dhe janë kthyer te të vetët duke i lajmëruar lidhur me këtë. Lidhur me këto argumente janë pajtuar të gjithë muslimanët.

Shumica e sahabëve³⁶ dhe nxënësve të tyre si dhe numri më i madh i dijetarëve të mëvonshëm gjithashtu kanë konsideruar që xhinnët janë kthyer te Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që t'u lexojë edhe diç nga Kur'ani dhe që pastaj ata i janë betuar atij për besnikëri.

Ata gjithashtu kanë besuar se xhinnët kanë kërkuar nga Resulull-llahu, sal-lall llahu alejhi ve sel-lem, që ai t'u caktojë ushqimin dhe shtazët e tyre, ndërsa

ky u kishte thënë: "Mund ta merrni çdo kockë (asht) në të cilën është përmendur emri i All-llahut pasi që ajo do të jetë e mbuluar me mish më shumë

seç u nevojitet, ndërsa për shtazë tuaja mund t'i merrni bajgën e shtazëve si ushqim."

Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu kishte thënë: "Mos u

pastroni me këto dyja (kocka dhe bajgë) sepse ato janë ushqim për vëllezërit

tu prej xhinnëve."

Ky version është transmetuar në mënyrë autentike sahih Muslim dhe përmbledhjet tjera të hadithëve në bazë të autenticitetit të Ibën Mes'udit."37

Në sahih Buhari dhe vepra tjera të hadithit, Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, ka transmetuar ndalimin e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të përdorimit të kockave dhe bajgës së shtazëve me qëllim të pastrimit.

Në një transmetim që e hasim në Sahih Muslim dhe përmbledhjet tjera të hadithit, një mik i Salmanit kishte pyetur: "A është e vërtetë se Pejgamberi juaj u ka mësuar për gjithçka, duke përfshirë edhe përdorimin e nevojtores?"

Ky i ishte përgjegjur: "Po.

Ai na ka ndaluar që gjatë kryerjes së nevojës të kthehemi në drejtim të kryerjes së namazit, na ka ndaluar që ta përdorim dorën e djathtë për pastrim pas kryerjes së nevojës, të pastrohemi me më pak se tre guralecë, ose të pastrohemi me bajga të kafshëve dhe kocka."38

Në Sahih Muslim dhe vepra të tjera të hadithit është transmetuar që Xhabiri, radijall-llahu anhu, kishte deklaruar: "Pejgamberi i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka ndaluar të pastrohemi me kocka ose mbeturina të kafshëve."39

Ngjashëm me këtë, kjo ndalesë mund të haset në hadithin e Huzejme ibën Thabitit, radijall-llahu anhu,40 dhe ata nga sahabë të tjerë.

Shkaku që ndodhet në prapavi të kësaj ndalese është përmendur në transmetimin vijues të hadithit i cili ndodhet në Sahih Muslim dhe përmbledhje tjera të haditheve. Ibën Mes'udi ka transmetuar që Resulull-llahu, sal-lall-llahu

alejhi ve sel-lem, ka deklaruar: "Më kishte ardhur një xhinn zëdhënës dhe unë shkova me te dhe u lexova Kur'an.

Pastaj ata më morën dhe m'i treguan rrugët e tyre dhe gjurmët e zjarreve të tyre, pastaj më pyetën t'ua caktoj ushqimin e tyre dhe unë u deklarova: 'Mund të ushqeheni me çdo kockë në të cilën është përmendur emri i All-llahut, e e cila u bie në dorë, dhe çdo bajgë e shtazëve për shtazë tuaja. Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pastaj kishte deklaruar:

'Prandaj mos u pastroni me to ngase janë ushqim për vëllezërit tuaj."41

Në Sahih Buhari dhe përmbledhje tjera të haditheve është transmetuar nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, që ai zakonisht ia mbante enën me cilën Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, merrte abdest dhe gjërat e tij (kur ky shkonte për të kryer nevojë).

Njëherë derisa ai (Ebu Hurejre) po e përcillte, ishte zhvilluar kjo bisedë: Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e kishte pyetur: "Kush është?" Unë u përgjegja: "Ebu Hurejre."

Ai foli:

"Më sill disa guralecë që të pastrohem, por mos më sill kocka apo bajgë shtazësh."

Unë ia solla disa guralecë dhe i lëshova afër pastaj u largova derisa ai nuk e kreu nevojën.

Kur e kreu e pyeta: "Ç'ka të keqe në kocka dhe bajgën e shtazëve?"

Ai u përgjigj: "Ato janë prej ushqimit të xhinnëve.

Vërtet më ka ardhur një delegacion i xhinnëve nga Nesibejni - ata kanë qenë më të mirët prej xhinnëve - dhe më kanë pyetur t'u caktoj me çka mund të ushqehen, andaj e luta All-llahun për ta që kur të kalojnë pranë ndonjë kocke ose bajge të shtazëve aty ta gjejnë ushqimin e vet."⁴² Ndalesa e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, lidhur me pastrimin e fecesit me ushqimin e xhinnëve dhe shtazëve të tyre, gjithashtu përmban ndalesë edhe më evidente kundër çdo gjëje që do të mund të ndotë ushqimin e njerëzve dhe ushqimin e shtazëve të tyre. Megjithatë, neveria e njeriut ndaj ushqimit i cili është ndotur me fëlliqësi është e natyrshme për njeriun prandaj edhe nuk është përmendur, e që nuk është rasti me kockën dhe bajgën e shtazëve, pasi që ushqimi i xhinnëve është i panjohur për njeriun.

Ekzistojnë shumë transmetime autentike në të cilat janë ndalesat e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ndalimi i përdorimit të kockave dhe bajgëve me qëllim të pastrimit, njësoj siç përbëjnë argument se ai ka biseduar me xhinnët, se u ka lexuar Kur'an dhe sa ata kanë kërkuar prej tij t'u caktojë ushqimin.

Në Sahih Buhari dhe Sahih Muslim transmetohet nga Ibën Abbasi të ketë thënë: "Vërtet Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurrë nuk ka parë xhinn as ka biseduar me të, megjithatë, është njoftuar (nga All-llahu) se ata e kanë dëgjuar Kur'anin."

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, e ka ditur ç'ka thënë Kur'ani lidhur me këtë, mirëpo nuk e ka ditur atë që e ka ditur Ibën Mes'udi, Ebu Hurejre dhe sahabë të tjerë në lidhje me vizitën e xhinnëve te Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, bisedën e tyre me të dhe se Kur'ani u drejtohet në mënyrë që t'i njoftojnë të tjerët për këtë.

Kjo ka ndodhur në fillim të Islamit kur qiejt u bënë mirë të ruajtura dhe xhinnët janë penguar të marrin informacione nga qielli ku ishin vendosur roje të fuqishme.

Ky fenomen është njëri prej argumenteve të pejgamberisë së Muhammedit dhe përmban lekcion i cili është sqaruar më hollësisht në disa vende të tjera. Pas kësaj, xhinnët i kishin ardhur dhe pasi u kishte recituar suren "Er-Rahman", ndërsa kur recitonte ajetin i cili përsëritet: E, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni (ju o njerëz dhe ju o xhinnë)?! - ata përgjigjeshin: "Nuk ka asnjë prej simboleve tuaja që e mohojmë - Ti qofsh madhëruar."⁴³

All-llahu i Madhëruar e ka siguruar bazën për mirëkuptim të kësaj çështje ashtu që ka përmendur në Kur'an shumë deklarime që i përshkruhen banorëve të dy botrave:

O grumbull i xhinnëve dhe i njerëzve!

A nuk ju erdhën nga mesi juaj të dërguar t'ju rrëfejnë argumentet e Mia dhe t'ju tërheqin vërejtjen për takimin tuaj në këtë ditë?

Ata thonë: "Dëshmojmë kundër vetvetes". (En'am: 130)

Në një vend tjetër në Kur'an, All-llahu, xhel-le shanuhu, na lajmëron për xhinnët duke theksuar se disa prej tyre kanë deklaruar:

Është e vërtetë se prej nesh ka të mirë, por edhe që nuk janë aq të mirë, sepse ne kemi qenë në drejtime të ndryshme. (Xhinn: 11)

Në mesin e xhinnëve dallohen shumë sekte: muslimanë, jobesimtarë, ata që e pasojnë Sunnetin dhe heretikët që sjellin risi.

All-llahu i Madhëruar, gjithashtu ka theksuar të kenë deklaruar:

Është e vërtetë se prej nesh ka besimtarë (muslimanë) dhe prej nesh ka që

janë jashtë rrugës (jobesimtarë), e kush e pranoi Islamin, të tillët mësynë rrugën e shpëtimit.

Ndërsa, ata që lëshuan rrugën, ata u bënë lëndë e Xhehennemit!

(Xhinn:14-15)

Fjala kasit (sh. kasitun) është sinonim për fjalën xha'ir (tiran,ekstravagant), ndërsa folja kasete përdoret kur një individ gabon, derisa aksete përdoret kur veprohet drejt.

Jobesimtarët nga ana e xhinnëve do të dënohen në ahiret dhe me këtë pajtohen të gjithë dijetarët islam.

Sa i përket besimtarëve në mesin e tyre, shumica e dijetarëve supozojnë se do të shkojnë në Xhennet.

Në një version të hadithit thuhet: "Xhinnët do të vendosen në periferi të Xhennetit ku njerëzit do të mund t'i shikojnë, kurse ata nuk mund t'i shikojnë këta."⁴⁴

Kjo deklaratë i është përshkruar imam Malikut, Esh-Shafi'ut, Ahmedit, Ebu Jusufit dhe Muhammedit.⁴⁵

Nga ana tjetër, është transmetuar se Ebu Hanife ka qenë i mendimit se shpërblimi i tyre do të jetë shpëtimi nga zjarri.

Shumica e dijetarëve e kanë mbështetur qëndrimin e sipërshënuar duke theksuar ajetin vijues i cili i përshkruan vajzat e Xhennetit:

Ato nuk ika prekur kush para tyre, as njeriu as xhinni. (Rahman: 56,74)

Duke u thirrur në ta ky ajet argumenton se xhinët do të ndodhen në Xhennet, ngase ky ajet dëshmon për atë se ata do t'ua marrin virgjërinë vajzave (Hur el-Ajn) vendbanimi i cilave është vetëm Xhenneti.⁴⁶

27 Sahihul-Muslim, vol. III, tq. 1197, nr. 5457.

28 Ibid, tq. 1197, nr. 5456

29 Në mesin e shkollave greke të mendimit filozofik, vetëm epikurejasit kanë pohuar se nuk ekzistojnë krijesa të tilla siç janë demonët, e nëse

edhe ekzistojnë, është e pakuptueshme që mund të marrin formë njerëzore, ose që mund të komunikojnë me ne përmes fjalëve ose në ndonjë mënyrë ljetër.

Nga ana ljetër, Platoni dhe Aristoteli e kanë pranuar qëndrimin e popullarizuar mbi demonët, si diç që është identike me shpirtrat e të vdekurve.

Sipas mendimit të tyre çdo njeri ka një demon të caktuar i cili e pason gjatë jetës dhe pas vdekjes së tij.

30 Duke pasur parasysh shkakun e shtrëngimeve epileptike, mjeksia moderne i ndanë në dy kategori: epilepsinë simptomatike tek e cila shkaktari mund t'i përshkruhet ndonjë gjendje fizike siç është dëmtimi i trurit, derdhjes në tumore eij., dhe epilepsi idiopatike e cila nuk mund t'i përshkruhet shkaktarëve të njohur (Current Medical Diagnosis & Treatment, California: Lange Medical Publications, Middle East Edition, 1982, fq. 575).

31 Fushat medicinale të psikoterapisë, psikiatrisë dhe psikologjisë dëshmojnë për një ndikim më të fuqishëm të shpirtit në trup se vetë medikamentat.

32 E ka transmetuar Safija, ndërsa gjendet në gjashtë përmledhjet e hadithit pos te Tirmidhi. E transmeton edhe Enesi në Sahihul Muslim, vol. III, tq. 1188, dhe në Sunen Ebu Davud, vol. III, 1390, nr. 4976.

33 Këtu nga ana e autorit është bërë dallim ndërmjet jetës së trupit i cili mund të ekzistojë ndaras nga shpirti, si në rastet ku sot trupat mbahen "të gjallë" nga ana e pajisjeve gjatë kohë pasi shpirti është ndarë prej tyre. Kjo gjithashtu është e ngjashme me jetën e tetusit para se t'i jepet shpirti në muajin e pestë, e në bazë të deklaratës së Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Vërtet, krijimi i çdonjërit prej jush kryhet në mitrën e nënës dyzetë ditë si pikë vaji, pastaj si ngjizje gjaku një periudhë të ngjashme, pastaj si copë mishi në një periudhë të ngjashme me atë. Pastaj dërgohet meleku i cili ia jep shpirtin..." (Transmeton 'Abdullah ibën Mes'udi ndërsa e ka përmbledhur Buhariu dhe Muslimi, Sahih Buhari, vol.4, tq. 290-291, nr. 430).

34 Emri i shejtanit i cili pënnendet në Kur'an në shumë vende (2:34; 7:11; 15:31,32; 17:61; 18:50; 20:116; 26:95; 34:20 dhe 38:74, 75).

35 Ashtu që ky njeri mund të vazhdojë të bëjë vepra të tilla të mosbesimit dhe të nxitë të tjerët t'i bashkohen suksesit të tij.

36 Është transmetuar në një hadith autentik që Ibën 'Abbasi, radijall-llahu anhu, e kishte mohuar ardhjen e tyre te Resulull-llahu, sai-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe mësimin e tij nga Kur'ani lidhur me ta (Sahihul-Muslim, val. I, fq. 234-5, nr. 902).

Megjithatë Ibën Mes'udi, radijall-llahu anhu, dhe Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, e kanë konfirmuar këtë. Prandaj mohimi i Ibën 'Abbasit konsiderohet vetëm mohim i njohurisë së tij lidhur me këtë ngjarje.

Ibën 'Abbasi, radijall-llahu anhu, me gjasë më vonë e ka ndryshuar qëndrimin e vet, pasi që Ibën Xheriri kishte transmetuar që Ibën 'Abbasi

është pajtuar me Ebu Hurejren, radijall-llahu anhu, lidhur me këtë çështje (Ibni Kethiri për këtë hadith thekson se është i fortë).

37 Sahihul-Muslim, val.1, fq. 244, nr. 903

38 Sahihul-Muslim, vol.1, tq. 160, nr. 504

39 Ibid., vol.1, tq. 160, nr. 506

40 E shënojnë Ebu Davudi dhe Ibën Maxhe. Rrëfimet tjera të këtij ndalimi mund të hasen në hadithin të cilin e transmeton Ruvejt ibën Thabiti, e cilin e ka shënuar Ebu Davudi (Sunen Ebu Davud, vol.1, tq. 9,nr. 36) dhe En-Nisa'i, kurse prej Sahl ibën Haniteit në Musned nga Ahmed, Megjithatë, të gjithë zinxhirët e transmetuesve janë të dobët.

Një version tjetër të cilin e transmeton Zubejr ibën el-'Avvami, e cilën e shënon Et-Taberani, gjithashtu është i dobët.

41 Sahihul-Muslim, vol. 1, tq. 244, nr. 903.

42 Sahih Buhari, vol.5, tq. 126, nr. 200

43 Transmeton Xhabiri, ndërsa e shënon Et-Tirmidhi. Ibën Xheriri e shënon gjithashtu nga Ibën Omeri me zingjir të mirë të transmetuesve (Shih Muhammed Nasirud-din el-Albani Sahih el-Xhami' es-Sagir ve Zijadetuhu (Bejrut: El-Mekteba el-Islami, botimi i dytë, 1986, vol.5, tq. 30).

44 Ibën Tejmilië në një vend tjetër thekson se këtë hadith e shënon Et-Taberani nga Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Megjithatë Ibën Kethiri konsideron që ky nuk është hadith porse thenie (Tefsir el-Kur'an el-'Adhim, vol.4, nr 171).

45 Ebu Jusufi dhe Muhammed esh-Shejbani kanë qenë dy nxënës të imam Ebu Hanifes.

46 Ibën Kethiri ka deklaruar: "Kjo mënyrë e rezonimit është pyetëse. Argument më të mirë për hyrjen e xhinnëve në Xhennet është deklarimi i All-llahut:E për atë që i pat frikë paraqitjes para Zotit të vet,janë dy Xhennete, e cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni? (Kur'an, 55:46-7). Lavdiploti i ka bekuar qeniet e të dy botëve ashtu që ka krijuar shpërblim për të drejtët prej tyre në Xhennet... (Tefsir el-Ku'ran el-Adhim vol.4, fq. 171).

Domethënia: në harmoni me traditën krishtere nuk do të ketë marrëdhënie seksuale në Xhennet, ndërsa në bazë të thënies e cila i përshkruhet Isait,alejhis-selam, ku ai kinse ka deklaruar se nuk do të ketë martesë në Xhennet (Mateu 22:30 - "Ngase në jetë pas vdekjes nuk martohen as meshkujt as femrat, por janë si engjëj në parajsë."

Shih, gjithashtu, Marku 12:25 dhe Lluka 20:35).

Megjithatë në burimet islame, kënaqësitë në Xhenet janë zgjerim i paparamendueshëm i kënaqësive të kësaj bote (d.m.th. lumejt nga qumështi,vera dhe mjalti (47:15).

Në përpjekje për fiu përgjegjur lexuesit perëndimor: përfaqësues të rrethit historik krishter - disa përkthyes të Kur'anit i kanë komentuar gabimisht ajetet e qartë lidhur me kënaqësitë seksuale në Xhennet në mënyrë simbolike.

Për shembull, në komentin e ajetit: Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë. (Kur'an, 2:25),(Shih fusnotën për ajetin 64 të sures 29, e gjithashtu komentin (tetsirin) e Ibën Kethirit, vëll. 1, fq. 63.) përkthyesi i Kur'anit Abdullah Jusuf Ali thekson:

"Pastaj ekziston partneriteti.

Nëse ka të bëjë me seksin, bashkimet e tyre fizike janë mohuar menjëherë me dhënine e fjalës mutahharatun "të shenjtë dhe të pastër". Gjuha arabe është në formë prerëse dhe duhet të përkthehet me dy mbiemra që përcaktojnë pastërtinë në formën më të lartë.

Partneriteti është i natyrës shpirtërore dhe ka të bëjë me të dy gjinitë e botës fizike të meshkujve dhe femrave." (A. Jusuf Ali, The Holy Qur'an, Bretwood Maryland: Amana Corp., 1983. fq. 22,44).

Ekzistojnë shumë ajete kur'anore dhe hadithe të Resulull-llahut, sai-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që kanë të bëjnë me aspektet fizike të mashkullit dhe femrës në Xhennet.

Pra, nuk mund të pohohet preras se ka të bëjë ekskluzivisht me "partneritetin e shpirtave" dhe se qeniet nuk posedojnë edhe trup edhe shpirt.

Shprehja mutehharatun në të vërtetë vetëm konfirmon që trupat në Xhennet do të jenë të lirë nga çdo e metë dhe prishje si në këtë botë, pasi që mjalti dhe qumështi i Xhennetit nuk prishen ose dehin.

Mutahharatun thjeshtë do të thotë i pastër dhe implikon diç të shenjtë.

Ibën Kethiri në komentimin e këtij ajeti ka transmetuar që sahabi Ibën 'Abbasi,radijall-llahu anhu, kishte deklaruar:

"(Ato janë) mutahherun (të pastra) nga material i ndotur dhe që prishet." Nxënësi i tij Muxhahidi ka deklaruar: "(Të pastruara) nga menzesi, fecesi, urinimi, jargët, pështyma, mukusi dhe lindja."

Në bazë të këtij interpretimi të gabuar, Jusuf Aliu i ka transmetuar gabimisht të gjithë ajetet paraprake lidhur me kënaqësitë fizike në Xhennet.

Për shembull, në suren "En-Nebe" (78) ai transmeton ajetin 33 (Ve keva'ibe etraban) si "partnerë të moshës së njëjtë." (The Holy Qur'an, fq. 1676).

Etraban do të thotë të një moshe duke u thirrur në Ibën 'Abbasin,radijall-llahu anhu. (Muhtesar Tefsir Ibni Kethir, vol.3, fq. 434 dhe 593), megjithatë,keva'ibe nuk do të thotë partneritet. Keva'ib është shumësi nga keva'ibe që nënkupton vajzë gjinjtë e cilës kanë filluar të rriten ose ajo që ka gjinj të theksuar. (E.v. Lane, Leksikon arabe-anglisht, vol. 2, fq. 2616). Ibën Kethiri ka theksuar që Ibën 'Abbasi dhe Muxhahidi kanë deklaruar: Keva'ib do të thotë nevahid".

Më pas ka sqaruar: "Ata (Ibni 'Abbasi dhe Muxhahidi) kanë menduar se gjinjtë e femrave të Xhenetit janë të theksuara dhe nuk janë të lëshuara ngase janë të virgjëra. (Shih sure el-Vaki'a 56:35-37)" (Muhtesar Tefsir Ibën Kethir, vol.3, fq. 593).

Ky ajet në realitet ka të bëjë me femrat në Xhennet si femra me gjinj të

theksuar të një moshe të njejtë.

Ky qëndrim i Jusuf Ali është mohuar nga ana e Mexhlisul-Ulema-së së Afrikës Jugore në veprën e tyre: A Discusion of the Errors of Yusuf Ali, (Transvaal,Rep. South Africa: Young Mens Association, fq. 16-26,44-50.)

Kaptina II

Xhindosja

Xhinnët janë qenie inteligjente të cilëve u është dhënë Shpallja e lartësuar me urdhra dhe ndalesa, prandaj janë të përshtashëm për shpërblim ose dënim në botën tjetër.

Pasi që Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,gjithashtu është dërguar edhe për ta, kjo i obligon muslimanët që ndaj tyre të sillen në mënyrë të njëjtë siç do të duhej të silleshin ndaj njerëzve tjerë duke pasur parasysh se urdhërojnë për mirë dhe largojnë nga e keqja.

Xhinnët do të duhej të ishin të ftuar ta konfirmuar All-llahun, xhel-le shanuhu,

pikërisht ashtu siç e ka ftuar Pejgamberi i Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,njerëzimin për ta konfirmuar këtë, dhe ashtu siç i ka ftuar Resulull-llahu,sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, edhe ata ta konfirmojnë.

Muslimanët gjithashtu do të duhej të sillen ndaj xhinnëve në mënyrë të njëjtë në të cilën do të silleshin ndaj njerëzve që i thyjnë ligjet e All-llahut.

Do të thotë, ata do të duhej të dëbojnë dhunën e xhinnëve duke i përvetësuar metodat e njëjta me të cilët dëbohet dhuna e njerëzve.

Xhindosja e kohëpaskohshme e njeriut nga ana e xhinnit mund të jetë si pasojë e dëshirave senzuale nga ana e xhinnit, ideve kapricioze, ose madje dashurisë, pikërisht në mënyrën në të cilën kjo mund të ndodhë mes

njerëzve.

Xhinnët dhe njerëzit gjithashtu mund të kenë marrëdhënie seksuale dhe të kenë fëmijë."

Ky është fenomen i shpeshtë dhe tejet i njohur për shumëkë. Dijetarët juridikë islamë këtë e kanë ndaluar rreptësisht.

Shumica e juristëve e kanë gjykuar martesën me xhinnët.

Megjithatë, xhindosja më shpesh është pasojë e frustracionit të xhinnëve pasi që u është shkaktuar ndonjë e keqe dhe prandaj ky veprim është dënim për ata që kanë bërë faj kundër tij.

Për shembull, kur njerëzit rastësisht u shkaktojnë dëm ose i lëndojnë duke urinuar mbi ta, duke derdhur ujë të valë mbi ta, ose duke vrarë ndonjërin prej tyre, xhinnët supozojnë se janë lënduar qëllimisht.

Ndonëse njerëzit nuk e kanë të qartë ç'kanë bërë xhinnët për nga natyra e tyre janë tejet të paedukuar, të vrazhdë dhe mendjelehtë në sjelljet e tyre,kështu që në shenjë hakmarrjeje mund t'i ndëshkojnë më tepër se sa

meritojnë.

Xhindosja e shejtanit, gjithashtu, nganjëherë paraqitet si pasojë e gabimit të madh, përcmimit ose ndonjë e keqe e thjeshtë nga ana e xhinnit siç lajmërohen prapësia dhe mashtrimi te njerëzit nga shkaqe të ngjashme me këto.

Në rastin e parë kur xhindosja është pasojë e shfrenimit nga ana e xhinnit, All-llahu, xhel-le shanuhu, këtë ua ka ndaluar si njerëzve ashtu edhe xhinnëve.

Pa pajtimin e njeriut i cili është xhindosur ky bëhet rast i veprës së vrazhdë dhe tiranisë.

Në raste të tilla xhinnëve duhet drejtuar dhe duhet njoftuar se veprat e tyre janë të mbrapshta dhe të ndaluara, ose të egra dhe tiranizuese, kështu që kundër tyre do të paraqitet argument në Ditën e Gjykimit dhe ata do të frikohen se e kanë thyer ligjin e All-llahut dhe ligjet e Pejgamberit të Tij, të cilin Ai e ka dërguar për të gjitha botërat: botës së njerëzve dhe botës së xhinnëve.

Në rastet e shembullit tjetër, kur njerëzit nuk janë të vetëdijsëm se u kanë shkaktuar dëm xhinnëve, do të duhej drejtuar xhinnëve për t'i lajmëruar se ky veprim i njerëzve ka qenë i paqëllimtë dhe si i tillë nuk meriton dënim.

Nëse kjo i ndodhë njeriut në shtëpi ose në pronën e tij, xhinni do të duhej të lajmërohet se kjo shtëpi dhe kjo pronë i përkasin atij njeriu, dhe si të tillë atyre u lejohet t'i përdorin në mënyrën në të cilën vetë ai (pronari i tyre) dëshiron në kufij të asaj që është e lejuar.

Xhinnëve gjithashtu duhet thënë se ata nuk kanë të drejtë të pushtojnë pronën e njerëzve pa lejen e pronarit.

Ata kanë të drejtë vetëm të banojnë në vendet që nuk janë të zënë nga njerëzit, siç janë objektet e pabanuara dhe sipërfaqet e hapura.

Prandaj xhinnët më shpesh mund të gjenden në gërmadhat e braktisura, shkretëtirën e pabanuar ose në fushë të gjerë.

Ata gjithashtu zënë vend edhe në vende të papastërta siç është nevojtorja, bërllogu dhe varrezat.

Personat që e bëjnë largimin e xhinnit shpesh largohen nga këto vende ku ata jetojnë më shpesh.

Ekzistojnë shumë hadithe të cilat flasin për ndalimin e kryerjes së namazit në vende të papastërta pasi që ato janë vendbanime të xhinnëve.⁴⁸

Disa dijetarë kanë konfirmuar se shkak i ndalimit të namazit në varreza dhe nevojtores është kauzaliteti i madh i ekzistimit të papastërtisë, derisa të tjerët kanë supozuar se kjo ndalesë është dispozitë e prerë fetare, qëllimi i të cilës është i pakuptueshëm.

Megjithatë, është qëndrim i drejtë është ai se shkak në rastin e nevojtores, stallës për deve dhe krejt asaj që është e ngjashme me to, është se janë vendbanime të shejtanit,⁴⁹ ndërsa në varreza ngase ai është mjedis për idhujtari, përpos që është vendbanim i shejtanit.

Asketët të cilët janë vënë në rrugë të gabuar dhe heretikët e përkushtuar

lutjeve të cilët përjetojnë fanitje dhe vizione, zakonisht izoloohen në vendet të cilat shpesh janë vizituar nga ana e shejtanit e në të cilët namazi është i ndaluar.

Ata i zgjedhin këto vende, sepse shejtani atje i viziton dhe mund të komunikojnë me ta në mënyrë të njejtë siç komunikojnë me magjistarët dhe ata që hedhin fall.

Xhinnët gjithashtu hyjnë edhe në idolë, duke iu drejtuar atyre që i adhurojnë idolët dhe i plotësojnë disa prej kërkesave të tyre.

Ata shpesh i ndihmojnë idhujtarëve të yjeve në kohën e kryerjes së ceremonialit të cilin xhinnët e konsiderojnë të përshtatshëm, si lutjet në formë të epeve drejtuar idolëve siç janë: dielli, hëna dhe planetet: si veshjen e idolit në rroba të bukura, temjanisjen, etj.

Shejtanët mund t'u paraqiten robërve të tyre në forma të cilët njerëzit i identifikojnë gabim si shpirtra të cilët njerëzit gabimisht i identifikojnë si shpirtra të lartësuar, ndërsa shejtanët mund t'i plotësojnë disa prej kërkesave të tyre duke mbytur armiqtë e tyre, duke përhapur ndonjë sëmurje tek ata, duke e bërë për vete dikë që dëshirojnë ata, ose duke u sjellur të mira materiale.

Megjithatë, prapësia që mund t'i godasë gjatë shfrytëzimit të këtyre shërbimeve është shumëfish më e madhe se dobia që e kanë kërkuar. Shumë prej atyre që shfrytëzojnë ndihmën e xhinnëve në këtë mënyrë pohojnë që Sulejmani, alejhis-selam, i ka shfrytëzuar xhinnët po në këtë mënyrë dhe po me këtë qëllim.

Shumë dijetarë nga periudhat më të hershme kanë dëshmuar lidhur me ekzistimin e librave të udhëzimeve mbi kthimin në mënyra të pamjaftueshme dhe pabesueshme të cilën e kanë shkruajtur shejtanët dhe e kanë vendosur nën fronin e Sulejmanit, alejhis-selam, pas vdekjes së tij.

Kur këto libra janë zbuluar, shejtanët pastaj pohuan se ato i ka shfrytëzuar edhe Sulejmani, alejhis-selam, si dhe atë që e kishte zakon të shfrytëzonte xhinnët në mënyrën siç e përshkruanin ata.

Pasoja ishte diskreditimi dhe përdhosja e Sulejmanit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nga ana e disa krishterëve dhe hebrenjve.

Të tjerët prej tyre gjenin arsyetim për aktivitetet e tyre magjistare duke pohuar se as Sulejmani, alejhis-selem, nuk do të ishte marrë me to nëse nuk do të ishte e lejuar.

Të dyja këto grupe kanë devijuar, njëri pse përhapte genjeshtra për Sulejmanin, alejhis-selam, ndërsa tjetri se e kishte zgjedhur magjinë.

Këto devojime ishin nxitje e drejtpërdrejtë për shpalljen e ajetit vijues nga ana e All-llahut të Madhëruar:

E kur u erdhi atyre ndonjë i dërguar prej All-llahut, vërtetues i asaj që kishin ata, një grup prej tyre të cilëve iu kishte dhënë libri, e hodhi pas shpine

librin e All-llahut, kinse nuk dinin (asgjë). (E hodhën librin e Zotit)

E ndoqën atë që thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit.
Por Sulejmani nuk ishte i pafe, djajt ishin të pafe, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën)
Edhe atë që u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit.
E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pafe!"
E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e All-llahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre.
E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin)e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit).
Po ta dinin, ata se për ç'ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe.
(Bekare: 101-102)

All-llahu i Madhëruar ka sqaruar se magjia vetvetiu nuk mund as të shkaktojë dëm as të sjellë farë dobie, ngase ajo që është vërtetë e dobishme duhet të jetë ose tërësisht e mirë ose të paktën e mirë që dominon, ndërsa diçka që është vërtetë e keqe duhet të jetë ose e keqe e tërësishme ose e keqe dominuese, përderisa dobia dhe dëmi gjatë magjisë është vetëm e pjesërishme. 50
Është me rëndësi të theksohet se nëse xhinnët e sulmojnë njeriun, do të duhet të njoftohen me dispozitat e All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, duke cekur gjatë kësaj edhe dëshmitë për gabimin e tyre.
Atyre do të duhej urdhëruar të jenë të drejtë dhe të kërkohet prej tyre të përmbahen nga e keqja, pikërisht siç bëhet edhe me njerëzit, ndërsa krejt kjo në bazë të fjalës së All-llahut:

Kush e udhëzon veten në rrugën e drejtë, ai e ka udhëzuar vetëm vetveten e vet, e kush e ka bërë humbjen kundër vetvetes së vet, e askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit.
E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin. (Isra: 15)

O grumbull i xhinnve dhe i njerëzve!
A nuk ju erdhën nga mesi juaj të dërguar t'ju rrëfejnë argumentet e Mia dhe t'ju tërheqin vërejtjen për takimin tuaj në këtë ditë? Ata thonë: ti Dëshmojmë kundër vetvetes".
I pat mashtruar ata jeta e kësaj bote dhe ashtu (të detyruar) dëshmuan kundër vetvetes se me të vërtetë e refuzonin (të vërtetën). (Enam: 130)
Pasojë e kësaj dsispozite ishte ndalesa e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për ndalimin e mbytjes së gjarpinjve të cilët gjenden në shtëpi derisa nuk u thuhet tri herë të largohen prej saj.
Në Sahih Muslim dhe ne vepra tjera të hadithit gjendet një traditë të cilën e transmeton Ebu Sa'id el-Hudri në të cilën theksohet që Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka deklaruar:
"Në Medinë ekziston një grup i xhinnëve që janë bërë muslimanë, andaj

kushdo që shikon ndonjë gjarpër (në shtëpi) duhet t'i urdhërohet tri herë të dalin prej saj.

Nëse ndonjëri prej tyre edhe pas kësaj lajmërohet, duhet mbytur ngase është shejtan."51

Në Sahih Muslim gjithashtu ekziston një traditë të cilën e transmeton Ebu es-Sa'ibî, robi i liruar i Hisham ibën Zehrehut, në të cilën thuhet:

"Njëherë e vizitova Ebu Sa'id el-Hudrin në shtëpinë e tij dhe pasi që ishte në namaz u ula dhe prita derisa të përfundonte.

Derisa po prisja, dëgjova se në njërin kënd të shtëpisë diç po lëvizte, ktheva kokën andej dhe për habinë time pashë një gjarpër.

U turra drejt tij për ta mbytur, mirëpo Ebu Sa'idi me isharet më urdhëroi të ulem, dhe unë u ula.

Kur gjarpri u largua, Ebu Sa'idi bëri me shenjë kah shtëpia tjetër dhe tha:

'Njëri prej çunave tanë i cili është martuar tani së voni ka jetuar në të.

Kur shkuam me Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], në betejë në Hendek⁵² djaloshi çdo kohë të drekës kërkonte leje nga Resulull-llahu, [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ta vizitojë bashkëshorten e vet.

Një ditë Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i lejoi të shkojë, por e porositi: - Merre me vete armën, ngase nuk i besoj fisit Kurejdha.⁵³

Ai i morri armët e veta dhe u kthye në shtëpinë e tij ku e gjeti bashkëshorten (krejtësisht të zhveshur) duke qëndruar në prag të shtëpisë së tyre.

Burrin e pushtoi xhelozia dhe ai nxori heshtën për ta therur.⁵⁴

Mirëpo, ajo nxitoi të sqarojë: - Mbaje heshtën tënde dhe hyn në shtëpi të shikosh çka më ka zhveshur.

Hyri në shtëpi dhe kur pa një gjarpër të madh që ishte bërë kulaç në shtratin e tij, nxori shpatën dhe e shkurtoi gjarpurin.

Doli jashtë për ta vënë në oborr, por gjarpri e shtrëngoi fuqishëm, kështu që nuk dihet se cili përfundoi më parë, djaloshi apo gjarpëri.

Ne shkuam te Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe e lajmëruam për të gjitha duke e lutur të kërkojë nga All-llahu, xhel-leh shanuhu, që ta rikthejë djaloshin në jetë për hir tonin.

Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, deklaroi: Vërtet në Medinë ekzistojnë xhinë që e kanë pranuar Islamin, andaj nëse e shikoni ndonjë, kërkonij prej tyre ta braktisin (shtëpinë) në periudhë prej tre ditësh, e nëse sërish paraqitet pas kësaj periudhe, mbyteni ngase ai është shejtani."

Në një hadith tjetër të cilin e citon Muslimi, është shënuar që Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Vërtet këto shtëpi kanë gjarpinj, prandaj nëse e shikoni ndonjë prej tyre, kërkonij tri herë prej tij ta braktisë shtëpinë.

Nëse e braktisë, atëherë është mirë, në të kundërtën mbyteni sepse me siguri është jobesimtar."⁵⁵

Pastaj ka thënë: "Shkoni varroseni vëllain tuaj!"

Kjo dëshmon për faktin se vrasja e xhinnëve pa ndonjë shkak është e ndaluar siç është e ndaluar vrasja e njeriut pa ndonjë arsye të madhe. Dhuna është e ndaluar në të gjitha rastet. Nuk është e lejuar të maltretohet askush, qoftë ai edhe jobesimtar. Në këtë aspekt Lavdiploti thotë:

O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë.

Kinie dro Allahun se All-llahu di hollësisht për atë që veproni. (Maide: 8) Xhinnët marrin forma të shtazëve si gjarpinjve, akrepave, deveve, lopëve, dhive, deleve, kuajve, mushkave, gomarëve dhe shpezëve. Pos kësaj ata mund të kenë formë të njerëzve, siç ka qenë në rastin kur shejtanët u kishin ardhur kurejshitëve në formë të Surak ibën Malikut kur deshën ta pushtojnë Bedrin.⁵⁶ me rastin e kësaj ngjarje, All-llahu ka shpallur:

Përkujto (Muhammed) kur shejtani u dha guxim për veprat e tyre dhe tha: "S'ka kush që mund t'iu mposhtë sot ju, unë jam mbrojtës Juaji!"

E kur u ballafaquan të dy grupet, ai u tërhoq prapa e tha: "Unë tërhiqem prej jush, unë shoh çka nuk shihni ju, unë i frikësohem All-llahut.

All-llahu ndëshkon shumë ashpër. (Enfal: 48)

Gjithashtu është transmetuar se shejtani ka marrë formën e plakut nga Nexhdi kur prijësit kurejshitë janë tubuar në hapësirën e tyre për mbledhje për të vendosur nëse Resulull-llahu, duhet vrarë, mbyllur apo ta dëbojnë.⁵⁷

Lavdiploti lidhur me këtë thotë:

Përkujto (o i dërguar) kur ata që nuk besuan thurnin kundër teje; të ngulojnë, të mbysin ose të dëbojnë.

Ata bënin plane, e All-llahu është më i miri që asgjëson (dredhitë). (Enfal: 30)

Pasi që gjarpinjtë e shtëpisë mund të jenë xhinnë, ata duhet tri herë të paralajmërohen të largohen.

Nëse ata janë vërtetë xhinnë dhe nuk largohen, atëherë mund të vriten, e nëse janë gjarpinj edhe ata gjithashtu mund të vriten.

Xhinnët të cilët vazhdojnë të frikësojnë njerëzit duke u transformuar në formë të gjarpërimit mund të sulmohen me të gjitha masat për t'i penguar në shkaktimin e prapësive të tjera.

Megjithatë, vrasja e tyre pa kurrfarë shkakut nuk është e lejuar.

47 Është e ditur se shumë priftërinj dhe motra nderi të Evropës mesjetare janë vizituar dhe dhunuar nga ana e demonëve epsh ndjellës femër të

cilët zyrtarisht janë quajtur Succub,si dhe engjëjve lakmues me emrin Incubi. Kështu, shumë motra nderi mbetën me barrë, ndërsa fëmijët e tyre janë varrosur menjëherë pas lindjes jashtë mureve të tempujve.

Papa Innocenti VIII, papa Benedicti XIV, Shën Augustini dhe Shën Thomasi,ndër prijësit ljerë fetarë, e kanë pranuar ekzistimin e Succubëve dhe Incubëve dhe këtij problemi i janë qasur fare seriozisht. (L.T. Hobhouse,Morals in Evolution: A Study of Comparative Ethiucs, (London:Chapman and Hall,1951) fq. 213, dhe Harold T. Christensen, Handbook of Marriage and the Family (Chicago: Rand McNally and Co., 1964. fq. 441).

Hulumtuesit bashkëkohorë përëndimorë këtë e kanë prezentuar si përpjekje të arsyetohet aktiviteti i vërtetë seksual në mesin e motrave të nderit dhe priftërinjve.

Megjithatë, nëse fakti të cilin e thekson Ibën Tejmie mbi xhinnët merret për bazë, disa nga rastet e theksuar mund të jenë realë, dhe jo tërësisht imagjinare siç është thënë më sipër.

48 Në hadithet e transmetuar nga ana e Ebu Sa'idit el-Hudrit, e që i ka tubuar Tirmidhi, Ebu Davudi (Sunnen Ebu Davud, vol. 1, tq. 125, nr. 492), Ibën Maxhe, Ibën Huzejme, Ibën Hibbani, El-Hakimi dhe të ljerë ndalohet kryerja e namazit në varreza dhe nevojtoje.

El-Albani zinxhirin e transmetuesve e ka vlerësuar si sahih, ndërsa në harmoni me kushtet që janë përdorur në dy Sahiha (Buhariu dhe Muslimi). Këto transmetime gjithashtu i kanë konfirmuar nga El-Hakimi dhe Ez-Zehebi. Argumentet e atyre që i kanë kritikuar këto hadithe nuk janë të nevojshëm t'i dobësojë.

Shejh El-Islami Ibën Tejmijje ka deklaruar si më poshtë: "Senedet e tij janë të mirë dhe kushdo që flet kundër kësaj nuk i ka konfirmuar të gjitha zinxhirët e tyre të transmetimit."

El-Buhariu gjithashtu ka udhëzuar për vërtetësinë e tij në kaptinën mbi kiraetin. (Shih El-Albani vepra Irvaa'el-hallil,(Bejrut: El-Mekteba el-Islami,botimi i parë, 1979, vol. 1, tq.

320). Hadithi mbi ndalesën të cilën e ka transmetuar Ibën Omeri gjithashtu e ka shënuar Et-Tirmidhi dhe Ibën Maxhe, mirëpo zinxhiri i tij i transmetuesve është i dobët.

Sa i përket hadithit në të cilin ndalohet marrja e varrezave për mesxhide, shumicën prej tyre i ka mbledhur El-Buhariu, Muslimi Sahihul-Muslim,vol. 1, tq. 769, nr. 1083) dhe të tjerët. Esh-Shevkani ka theksuar se Ibën Hazmi ka deklaruar: "Hadithet në të cilët ndalohet namazi që falet në drejtim të varrit ose në varreza janë mutevatir (kanë numër të madh transmetuesish në çdo nivel të zinxhirit të tij), prandaj askush nuk mund t'i lejojë vetes t'i mohojë."

(Nejl-Evtar, Egjipt: Halabi Press, n.d.), vol. 2, tq. 133).

Hadithet në të cilët ndalojnë namazin në vathët e deveve gjithashtu i ka mbledhur Muslimi (Sahihul-Muslim, vol. 1, tq. 198, nr. 700) dhe të tjerë.

49 Duaja për të cilën Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka

deklaruar se duhet të thuhet para hyrjes në nevojtoire tregon qartë se nevojtooret mund të jenë vendbanim i xhinnëve: All-llahumme inni e'udhubike min el-hubthi vel-habaithi. (e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi; Sahihul-Muslim vol. 1, fq. 205, nr. 729).

50 Do të thotë, dobia, qoftë financiare, psikologjike ose emocionale, në krahasim me dënimin në ahiret për shkak të kryerjes së magjisë është minimale.

Ngjashëm me këtë, dëmi paraqitet vetëm në një numër të vogël rastesh në raport me numrin e madh të provave dhe madje në disa raste (të suksesshme), i godet vetëm ata të cilëve All-llahu tanimë u ka përcaktuar që do t'u ndodhë.

51 Hadithi në fjalë dhe të ngjashëm me të përmbajnë në vete argumentin se xhinnët mund të marrin forma të ndryshme ose mund të thuhet se ata kanë gjendje të ndryshme prej cilave çdonjëri ka formën e vet stabile.

52 Mekelijtë paganë në vitin 627 (viti 5 h.) i kishin mbledhur shumicën e fiseve të shkretëtirës në përpjekjen e tyre të fundit për ta thyer Resulull-llahun, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe të gjitha bashkësitë e shumtë muslimane në Medinë.

Në mbrojtje të qytetit Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe sahabët grupuan një hendek përgjatë qytetit.

Kjo betejë është e njohur si beteja e Hendekut. (shih A. Guillaume, The Life of Muhammad, Karaçi, Pakistan: Oxford University Press, botimi gjashtë, 1980, fq. 450-60).

53 Njëri prej fiseve hebreje që banonte në Medinë. Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kishte marrëveshje me ta, të cilën ata e thyen gjatë betejës në Hendek.

Muslimanët pastaj ndërmorrën rrethimin e kështjellave të tyre dhe pasi i detyruan të dorëzohen, burrat e fisit u ekzekutuan për shkak të tradhtisë, ndërsa gratë dhe fëmijët u ndanë si robër në mesin e muslimanëve. (A. Guillaume, The Life of Muhammad, fq. 460-9).

Kjo marrëveshje është në pajtim me ligjin hebrej për banorët e qyteteve të robëruara qofshin ata tradhtarë apo jo: "Kur Zoti yt All-llahu t'i jep në duar, ekzekuto çdo mashkull që ndodhet aty me tehun e shpatës tënde; ndërsa femrat, edhe fëmijët, edhe bagëtinë, dhe gjithçka që ndodhet në qytet, merri për vete." (Deuteronomij 20:12).

Disa vjet para kësaj, prijësit e një fisi tjetër hebrej, të fisit Nadir, e kishin thyer aleancën me muslimanët duke tentuar vrasjen e Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Pohimet e tyre janë rrethuar dhe pas dorëzimit, Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e dëboi tërë fisin.

54 Ajo qëndronte jashtë shtëpisë e veshur dobët pa pjesën e epërme të rrobave e që ishte e pahiejshme për një grua të ndershme dhe prandaj i është dukur se ajo qëllimisht dëshironte të bënte lapërdhari.

55 Sahihul-Muslim, vol. IV, fq. 1213, nr. 5557.

Domethënia: Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, megjithatë

kishte bërë përjashtim duke i paralajmëruar gjarpijtë para vrasjes së tyre. Dy lloje të gjarpijve, El-Ebtar (gjarpijtë bishtashkurtër) dhe Zutaryetejn (të cilat i kanë dy njolla të bardha që i lëshohen nëpër trup) mund të vriten menjëherë, sepse Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë se mund të shkaktojnë vërbërinë dhe dështim.

Këto dy lloje mund të vriten menjëherë paparalajmërim, siç është rasti me gjarpinjtë e rrezikshëm që mund të hasen jashtë shtëpive. (Sahihul-Muslim, vol.IV, fq. 1211-2, nr. 5542-5545).

56 Isma'il ibën Kethiri, El-fusuk fi ihtisar sireh er-Resul, (Bejrut: Dar el-Kalem, botim i parë, 1980), fq.119.

57 The Life of Muhammad, tq. 221·2

Kaptina III

Të parët e shejtanit

Ata që marrin pjesë në magji dhe në betime shpesh ftojnë shejtanin për ta ndihmuar kundër të tjerëve.

Nganjëherë xhinni i keq e plotëson kërkesën e tij, por ata këtë shpesh nuk e bëjnë, përkundrazi nëse xhinni kundër të cilit kërkohet ndihmë është i respektuar në mesin e tyre.

As ai që kryen magji as magjitet e tij nuk kanë kurrfarë pushtet për t'i detyruar shejtanët që t'u ndihmojnë.

Magjistari me afsh fton qenien të cilën e konsideron të madhe -që mundet por nuk është e thënë të jetë ashtu - për të dëmtuar të tjerët që mund të jenë më të mëdhenj.

Në rastin kur individi i lutet xhinnit shumë për t'i shkaktuar dëm dikuj gjë që xhinnët e respektojnë shumë, këta do ta injorojnë.

Pozita e tyre është shumë e ngjashme me pozitën e njerëzve me dallim që njerëzit përgjithësisht janë inteligjentë, të drejtë dhe të sinqertë, përdërisa xhinnët janë injorantë, të pabesë, tiranë dhe mashtrues. Duhet theksuar se, ndonëse thirrja dhe magjitet e adhuruesve të shejtanit në vete mund të përmbajnë deklaramë të idhujtarisë dhe mosbesimit, ato janë shpesh joefikase kundër xhinnëve.

Kur kërkohet që të vritet ose kapet një xhinn tjetër i cili e ka pushtuar njeriun, xhinnët shpesh i mashtrojnë ata që e kërkojnë këtë duke u bërë sikur e kanë vrarë dhe eliminuar xhinnin sulmues, sidomos në rastet kur njerëzit besojnë në iluzione të cilët i përgadisin xhinnët.

Xhinnët zakonisht komunikojnë me ata që kërkojnë informacione në mesin e adhuruesve të idolëve qoftë përmes iluzioneve ose zërave.⁵⁸

Heretikët krishterë, hebrenjë dhe muslimanë kanë devijuar falë xhinnëve. Xhinnët mund të marrin formë të fotografisë së gjallë duke treguar kështu krejt atë që magjistarët dhe paralajmëruesit dëshirojnë ta dijnë.

Kur këta të shikojnë fotografinë e atij që kanë dashur ta shikojnë, ata i lajmërojnë njerëzit tjerë për këtë.

Disa prej tyre mund ta dijnë se kjo fotografi në të vërtetë është iluzion, derisa të tjerët mund të mashtrohen në besim që në relaitet janë dëshmitarë të pamjes së vërtetë. Xhinnët gjithashtu mund të bëjnë që njerëzit të dëgjojnë zërat e atyre që i kanë ftuar pasi të kenë shkuar.

Rastet e tilla janë më të shpeshtë në mesin e politeistëve, krishterëve, hebrenjëve dhe muslimanëve të paedukuar të cilët kërkojnë mbështetje tek ata që i konsiderojnë të shenjtë.

Kur disa magjistarë ftojnë sundimtarët e tyre shpirtërorë për ndihmë me fjalët: "O Zoti im kështu dhe kështu!", xhinnët do t'u drejtohen me zërin e mësuesve të tyre.

Kjo ka ndodhur me shumë njerëz prej të cilëve disa i njoh edhe personalisht.

Shejtanët shpesh do të përgjigjen derisa marrin trajtën e betimit, pa marrë parasysh është ai gjallë apo i vdekur, madje edhe nëse nuk frikohet nga ata që e ftojnë.

Personat e tillë bëjnë shirk në besimin e tyre të verbër që personi i ftuar përgjigjet, ndërkohë që në realitet është xhinni ai që përgjigjet.

Kjo shpesh ndodhë me krishterët të cilët ftojnë ata që i lartësojnë, qofshin të gjallë apo të vdekur, siç është Xhorxhi ose ndonjë person tjetër i shenjtë.⁵⁹

Kjo gjë shfaqet gjithashtu edhe te muslimanët heretikë të cilët ftojnë të vdekurit ose ata që nuk janë aty, ndërsa shejtanët marrin trajtën e atyre që ftohen ndërkohë që ky nuk e kupton këtë.

Kam dituri për shumë raste ku paraqitet ky fenomen dhe njerëzit që janë ftuar nuk e dijnë se janë ftuar, ndonëse ata që e kanë ftuar për ndihmë e kanë parë pamjen e tyre dhe kanë qenë të bindur se është fjalë për personin konkret. Më shumë se një person kanë deklaruar se më kanë ftuar gjatë ndonjë fatkeqësie, çdonjëri prej tyre duke rrëfyer ndryshe kinse unë u jam përgjigjur. Kur u kam thënë se nuk i jam përgjigjur kurrë, asnjëri prej tyre as kam ditur se më kanë thirrur, disa kanë deklaruar se ai me siguri ka qenë melek.

Unë u kam thënë se melekët nuk u ndihmojnë atyre që bëjnë shirk dhe se në të vërtetë ka qenë shejtani i cili është përpjekur t'i shpjerë në devijim.

Nganjëherë xhinnët marrin trajtë të atyre që janë shumë të çmuar dhe qëndrojnë në Arefat⁶⁰, dhe ata që kanë mendim të mirë për ta do të konsiderojnë se ai person ka qëndruar në Arefat.

Shumë të tjerë gjithashtu kanë qenë të bartur nga ana e shejtanit në Arefat dhe vende tjera të shenjta.

Në raste të tilla ata kalojnë mikatin (kufirin)⁶¹ pa veshjen formale të ihramit⁶²,

ose kryerjen e shumë rregullave të caktuara të haxhxit siç është kryerja e telbijes⁶³ ose tavafit rreth Qabës, dhe kryerjes së sajit ndërmjet kodrave Saffa dhe Merve⁶⁴.

Në mesin e tyre janë disa që nuk kalojnë as nëpër Mekë, të tjerët qëndrojnë në Arefat ndërkohë që nuk e kanë kryer obligimin e caktuar të hedhjes së gurëve në xhemrete etj ... përmes këtyre dhe mjeshtërve të tjera shejtani i shpie njerëzit e devotshëm në shkatërrim.

Në të vërtetë ata që janë të devotshëm ndër të përkushtuarit në këtë mënyrë janë mashtruar të bëjnë vepra të cilat janë të ndaluara (haram) ose të papëlqyeshme (mekruh) sipas fesë.

Shejtani ka mundësi që këto vepra të liga t'ua afrojë duke i bindur se janë keramete.

Megjithatë ato janë, pa dyshim, mashtrime të shejtanit, iluzione, ngase All-

llahu xhelle shanuhu, nuk mund të adhurohet përmes dispozitës fetare e cila nuk është as vaxhib as mustehab.

Kush kryen një vepër të adhurimit që nuk është as vaxhib as mustehab duke besuar gjatë kësaj se është e tillë, ai është mashtruar nga ana e shejtanit. Madje edhe nëse është vendosur që këtij personi t'i falet kjo vepër për shkak të qëllimit të mirë dhe përzemërsisë, ky akt vetvetiu ende është i papranueshëm për All-llahun, xhelle shanuhu⁶⁵ veprat e tilla nuk janë nga gjesëndet të cilat All-llahu i nderon shërbëtorët e Tij të devotshëm të cilët i janë të afërt, siç nuk ka respekt në kryerjen e haramit apo mekruh⁶⁶.

Respekti i lartësuar ndodhet në mbrojtjen e atij të cilin All-llahu, xhelle shanuhu, e don deri në kryerjen e veprave të tilla dhe në pengimin e tij për të

mos i kryer.

Ngase, kryerja e kundërvajtjeve e poshtëron atë që i kryen dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i sjellë dobi, madje edhe nëse për këtë nuk ndëshkohet. Kryerja e veprave të papëlqyeshme ose haram domosdo zvogëlon nivelin shpirtëror të atij që i kryen njësoj si dhe të atyre ithtarëve të tij që i lavdërojnë dhe madhërojnë.

Sepse, lavdërimi i veprave të ndaluara dhe të qortuara, dhe respektimi i atyre që i kryejnë është pa dyshim mënyrë e largimit nga rruga e All-llahut. Sa më shumë që njeriu hyn në risi (bid'at) duke shfrytëzuar gjykimin e pavarur (ixhtihad), aq më shumë largohet nga All-llahu, për arsye se kjo risi e largon nga rruga e All-llahut;

Të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu:

(me)pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. (Nisa: 69) dhe jo

në rrugën e atyre ndaj cilëve je i hidhëruar, dhe që janë të humbur.

(Fatiha: 7)

Ibni Tejmijje ka përmendur rastin e vijues⁶⁷ në histori në aspketin e El-Hallaxhit⁶⁸ dhe grupit të ithtarëve të tij: "Disa prej tyre kanë kërkuar pak ëmbëlsira për El-Hallaxhin, prandaj ai ishte ngritur dhe kishte shkuar deri në një vend të caktuar pak më larg, për t'u kthyer me plot ëmbëlsira.

Më vonë është zbuluar se ishin vjedhur nga një shitore e ëmbëlsirave në Jemen dhe se shejtanët i kishin sjellur aty."

Ibën Tejmijje lidhur me këtë rast kë treguar:

"Rastet e ngjashëm me këtë kanë ngjarë edhe te të tjerët, siku El-Hallaxhit, kanë arritur kulminacionin e deklarimeve të shejtanit, dhe ne dijmë për disa njerëz të tillë në kohën tonë njësoj si dhe në kohërat e shkuara.

Për shembull, ekziston një person i cili jeton në Damask të cilin shejtani e ka zakon ta bartë prej malit Salihije deri në një fshat në rrethin e

Damaskut.

Ai paraqitej nga retë dhe hynte nëpër dritaret e shtëpive në të cilat tuboheshin njerëzit për të mundur të jenë dëshmitarë të "hyrjes së tij të jashtëzakonshme".

Ibni Tejmijje gjithashtu ka përmendur një mistik tjetër i cili kishte pranuar se ka bërë lapërdhari me një grua dhe se ka dhunuar fëmijët meshkuj.

Ai kishte deklaruar: "Një qen i zi me dy njolla të bardha në mes syve më erdhi dhe më tha: 'Vërtet filan personi është përbetuar në ty dhe do të vijë nesër që të lajmërojë për këtë.

Unë tanimë i kam plotësuar nevojat e tij për hir tëndin.⁶⁹ ai person pastaj i vinte të nesërmen dhe mistiku i sqaronte hollësitë e betimit të tij dhe se ajo është e plotësuar.

Mistiku vazhdonte duke thënë: 'E kisha zakon të ecja nëpër qytet ndërsa drita në maje të shkopit që e mbaja ma ndriçonte rrugën'."

Ibni Tejmijje deklaroi: "Kur ky mistiku u pendua dhe filloi të falet, agjërojë dhe të pargohet nga e ndaluara, qeni i zi u zhduk."

Ai gjithashtu ka transmetuar një rrëfim tjetër për një mistik tjetër i cili ka pasur ndihmën e shejtanëve të cilët i ka dërguar t'i xhindosin njerëzit: "Kur familja e të xhindosurit vinte për të kërkuar ilaç, ai dërgonte një porosi miqve të tij, shejtanëve, dhe ata e lironin personin e pushtuar, e si pasojë e kësaj, mistikut i jepnin shumë dirhemë për shërbime.

Nganjëherë xhinnët i sillnin dirhemë dhe ushqim që i vjedhnin nga njerëzit, deri në atë masë sa mistiku kërkonte hurme nga shejtanët dhe ata i sillnin nga shportat në të cilat njerëzit i ruanin hurmat e tyre. Kur pronarët e këtyre shportave i kërkonin hurmat e tyre e shihnin se ato janë zhdukur."

Lidhur me një mistik tjetër, Ibni Tejmijje transmeton: "E kam njohur një mistik i cili ka poseduar njohuri shkencore dhe dituri nga Kur'ani.

Njëherë te ai kishin ardhur shejtanët dhe e kishin mashtruar.

Ata i kishin thënë se prej atij momenti prej tij nuk kërkohej namazi dhe se ata do t'i sjellin gjithë çka dëshiron.

Madje posa kërkonte diç, ata i sillnin shumë ëmbëlsira dhe fruta.

Kjo vazhdoi derisa disa dijetarë të cilët i kishte vizituar nuk i kishin propozuar të pendohet dhe t'ua kompensojë pronarëve të ëmbëlsirave dëmin që u kishte shkaktuar derisa ishte nën ndikimin e xhinnëve."

Më pas ai kishte deklaruar: "Shumë prej atyre që kërkojnë ndihmën e shej hëve kur kanë nevojë me fjalët: 'O mësues kështu është puna, ose o shejh kështu është puna, plotësoma nevojën, e kanë parë fotografinë e shejhut duke u thënë: 'Do ta plotësoj nevojën dhe do ta lehtësoj zemrën, pastaj i plotëson nevojat e tij dhe i mposhtë armiqet e tij.

Në raste të tilla shejtani e merr trajtën e shejhut, me ç'rast këta kanë bërë shirk duke i përshkruar partner All-llahut dhe duke kërkuar ndihmë prej dikujt tjetër dhe jo prej Tij."

Ibni Tejmijje pastaj fillon numërimin e rasteve të tilla në të cilët ka marrë pjesë vetë duke theksuar: "Kam njohuri për shumë raste të tilla, madje edhe në mesin e miqve të mi që kanë kërkuar ndihmën time në kohën kur janë goditur nga ndonjë fatkeqësi.

Njëri kishte frikë nga romakët, ndërsa tjetri kishte frikë prej tatarëve.

Të dytë kanë deklaruar se kanë kërkuar ndihmën time, se më kanë parë në ajër dhe se unë i kam mposhtur armiqtë e tyre për ta. Unë u bëra me dije se nuk e kam dëgjuar vajin e tyre as kam mposhtur armiqtë e tyre.

Ai ka qenë shejtani që ka shfrytëzuar pamjen e time për t'i mashtruar kur ata i kanë përshkruar shok All-llahut të Madhërishëm.

Ngjarje të ngjashme u kanë ndodhur gjithashtu nxënësve të miqve të mi dijetarë, ku disa prej tyre kanë kërkuar mbështetje tek ata dhe e kanë parë se

ata ua kanë plotësuar nëvojat. Dijetarët gjithashtu e kanë hedhur poshtë këtë

akt dhe kanë paralajmëruar se kjo në realitet është vepër e shejtanit."70

Në një vepër tjetër, Ibën Tejmijje ka deklaruar: "Njoh njerëz të cilët bisedojnë me bimë të cilat i lajmërojnë për pjesët e dobishme të tyre.

Megjithatë kjo në realitet është shejtani i cili ka hyrë në bimë dhe flet prej tyre.

Gjithashtu njoh disa të tjerë të cilëve gurët dhe drurët u thonë: "Urime, o mik i All-llahut, dhe kur njerëzit lexojnë Ajetul-Kursij (Bekare: 255) kjo ndëprehet, Kam njohur edhe njerëz të tillë të cilët kanë shkuar në gjueti të shpezëve ndërsa trumcakët u kanë folur: 'Më merr ashtu që të mund t'më hajë ndonjë skamnor.'

Raste të tillë janë vepra të xhinnëve të këqij kur i xhindosin shpezët në mënyrë të njejtë siç i xhindosin njerëzit dhe flasin përmes tyre.

Ekzistojnë edhe të tjerë të cilët, derisa janë në shtëpitë e tyre, shohin jashtë ndonëse dyert e shtëpive janë të mbyllura dhe e kundërta."71

Njeriu i tillë gjithashtu mund të transmetohet nëpër dyer të mbyllura të qytetit dhe të kthehet mbrapa shumë shpejt, e krejt kjo nga ana e xhinnëve.

Dritat mund të ndriçojnë ate ose ndonjëri prej miqve të tij mund ta thërrasë por, nëse ai e reciton Ajetul-Kursijen pandërprerë, krejt kjo do të zhduket."

Ai gjithashtu ka deklaruar: "Disa mistikë gjithashtu kanë thënë se xhinnët a kanë treguar diç shkëlqese si uji dhe qelqi ku kanë mundur të shikojnë pamjet e krejt asaj që kanë dashur ta dijnë, e pastaj këta i kanë informuar njerëzit."

Ibën Tejmijje ka përmendur edhe shumë shembuj tjerë, për të përfunduar!

"Kjo gjithashtu është temë e madhe sa sikur do t'u numëroja të gjitha rastet që i di lidhur me këtë temë, do të shkoja vërtet shumë larg, ndërsa libri me siguri do të dyfishonte vëllimin."72

58 Tubimi i informacioneve të fshehta përmes iluzioneve dhe zërave është dokumentuar mirë në mesin e njerëzve me fuqi parashikuese dhe ndërmjetëse.

"Ndërmjetësi" mund të definohet si personi përmes shërbimeve apo përmes organizimit të të cilit pranohen komunikimet kinse nga njerëz të vdekur ose qenie të izoluara.

Në atë që quhet "ndërmjetësim parashikues" (tani e popullarizuar si kanalizim) qenia "dëgjon" apo "shikon" miqtë ose farefisën e vdekur të personit prezent dhe ia transmeton porosinë e tyre.

Thënë në përgjithësi, sa i përket këtyre përvojave me sa duket se nuk kanë vërtetësi të perceptimit të rregullt por më parë shikojnë dhe dëgjojnë "me sy të mendjes" ose vesh.

Nganjëherë, ndërkaq, të shikuarit e pamjeve ose të dëgjuarit e zërave mund ta arrijë qartësi halcinatore; përvoja e ndërmjetësit pastaj kalon tek ai që është dëshmitar i fenomenit. (Benjamin B. Volman, botimi, Handbook of Parapsichology, New York: Van Nostrand Reinhold Company, 1977, fq. 579-580.)

59 Romë, 24 shkurt (AFP) - Shitësi rrugor i gazetave në Itali Renato Baron pohon se kishte parë dhe kishte biseduar me virgjëreshën Maria.

Vizionet që i kishte pasur Baroni dhe rreth tridhjetë persona të ljerë kanë tërhequr dhjetëra mijëra njerëz nga mbarë Italia, Fraca, Belgjika dhe Gjermania në një kodër në afërsi të Venedikut, duke shkaktuar kështu shumë tollovi në komunikacion (Arab News, vol. 33 XIV, nr. 90, e shtunë, 25 shkurt, 1989, fq. 24).

Ambridge, Pensilvania - Një kishë romanokatolike në qytezën e Pensilvanisë po përgatitej për pranimin e pelegrinëve me rastin e "Mrekullisë së të Premtes së Madhe" në të cilën "sytë e Krishtit" befasisht janë mbyllur.

Prifti dhe shumë famullitarë të tij kishin treguar se sytë e statusë, së sajuar në madhësi të natyrshme që paraqet flijimin e Krishtit, e të cilat janë të mbyllura tani 60 vjet përmjërë u mbyllën gjatë kohës së mbajtjes së shërbesës. (The Times, e hënë, 10 prill 1989, nr. 63, 364, fq. 8).

Në vitin 1981 një grup prej pesë fëmijësh po luanin në bregoren afër një fshati në Bosnje e Hercegovinë të quajtur Megjugorje kur para tyre është paraqitur vizioni i një femre të bukur e cila u ka pohuar se është Virgjëresha Marie e Bekuar.

Prej vitit 1981 rreth 7 apo 8 milionë pelegrinë nga vende, kultura dhe traditash krishtere të ndryshme të botës e kanë vizituar kondrën e shenjtë në Megjugorje.

Në ora 7. 30 çdo mbrëmje pelegrinë dhe turistë tubohen në grupe rreth kishës së atjeshme duke shikuar në dritaren e vogël të bodrumit, duke shpresuar se do ta kapin vezullimin e rrymimit të dritës që do të nënkuptonte që fëmijët, të cilët edhe më luajnë aty çdo ditë, kanë pasur

kontakt me Virgjëreshën Marie. (Newsletter of the International Religious Foundation, Inc. vol. II, nr. 6, nëntor-dhjetor, 1987. fq. 1-2).

60 Rrafshnalte rreth 20 kilometra larg Mekes, ku ditën e 9-të të Dhul-Hixhxes (muaji i dymbëdhjetë i kalendarit lunar), tubohen pelegrinët që e kryejnë haxhxin, për të falur namazin e drekës dhe ikindisë, të degjojnë hutben dhe të madherojnë All-llahun deri në muzg.

61 Pese stacione që e sajohen kufirin rreth Mekes që nuk mund ta kalojnë nga ana e atij që dëshiron ta kryejë haxhxin ose umren pos në gjendje të ihramit.

62 Për meshkuj, ihrami përfshin mbajtjen e dy fustanellave, njëri rreth belit, ndërsa tjetri i hedhur mbi dy supet, me qëllim të kryerjes së haxhxit ose umres.

Gratë mund të bartin çfarëdo veshje që ia mbulon tërë trupin pas duarve dhe fytyrës.

Gjatë kohës së haxhxit, individë që është në këtë gjendje nuk mund ta përdorin parfumet, të prejë aje shkule floket, ose të kryejnë marrëdhënie seksuale.

63 Lebbejk All-llahumme lebbejk, Lebbejk La Sherike Leke Lebbejk, Innell-Hamde ve Ni'mete Leke vel-Mulk, La sherike Lek /të përgjigjem o All-llah, të përgjigjem.

Të përgjigjem Ty që nuk ke shok, të përgjigjem.

Vertet tërë falenderimi, bekimi dhe drejtësia të takojnë vetëm Ty.

Ti nuk ke shok.

Kjo dua recitohet me ze gjatë veshjes së ihramit derisa të mos duket Qabja.

64 Dy kodra të vogla afër Qabes.

Gruaja e Pejgamberit të All-llahut Ibrahimit, alejhis-selam, Haxherja ka vrapuar ndërmjet tyre duke kërkuar ujë për femijën e saj të vogël Isma'ilin dhe për vete.

Të ecurit ndërmjet tyre shtatë herë është një nga rregullat e haxhxit dhe umres.

65 Shembulli mund të verëhet në besimin e gabuar nga ana e disave që koka e mashkullit duhet domosdo të jetë e mbuluar gjatë kohës së kryerjes së namazit sic është rasti nër hebrenjë ose që koka e gruas gjithashtu duhet të jetë e mbuluar derisa lexon /reciton/ Kur'an.

Megjithatë, Resulull-llahu, sallall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk ka urdheruar që kjo duhet të bëhet as e ka preferuar këtë porse ky është pasim i zakoneve të njerezve të asaj kohe.

66 "Kush futë në islam diç që nuk i përket do të refuzohet." (Transmeton

Aisha, radijall-llahu anha,ndërsa e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, (Sahih Buhari, vol. 3, fq. 535, nr. 861).

67 Këtu fillon fragmenti nga vol. 35 i komentimit të Ibën Tejmines,Mexhmu el-Fetava.

68 El-Husejn ibën Mensur El-Hallaxhi (858-922) ka mësuar nga dijetarët e shquar sufistë të kohës,(Tastari, 'Amr Mekiu dhe Xhunejdi) pastaj ka këputur lidhjet me ta dhe ka udhëtuar nëpër botë për të ligjëruar për asketizmin dhe misticizmin në Horasan, Ahvaz, Fars, Indi (Guxhret) dhe Turkistan.

Pas kthimit në Bagdad nga Meka, në vitin 908, shumëkush ishte interesuar për mësimet e tij, ndërsa nxënësit u tubuan shpejt rreth tij. Ai predikonte se pesë themelet e islamit mund të zëvendësohen me vepra të ljera.

Ai gjithashtu predikonte për ekzistimin e Shpirtit të pakrijuar Hyjnor (Ruh Natika) i cili mund ta bashkohet me shpirtin e krijuar të mendimit asketik, dëshirës dhe pranimit për vuajtje.

Në këto mësimet valijetë shndërrohen në dëshmitarë të gjallë të All-llahut. (H.A.R. Gibb dhe J.H. Kramers,Encyclopedi of Islam, Ithaca, New York: Cornell University Press, botimi i parë, 1953, fq. 127-8.

Në këtë vepër ka shkruajtur si vijon:

"Nëse nuk e njeh Zotin, të paktën shenjat e Tij, Unë jam e Vërteta Madhështore (Ende el-Hakk), pasi që me anë të vërtetës, unë jam e vërteta e amshueshme.

Miqte dhe mësuesit e mi janë Iblisi dhe Faraonët.

Iblisi është frikësuar nga zjarri i Xhehennemit, megjithatë ai nuk është lutur për falje.

Faraoni është fundosur në fund të detit, megjithatë nuk është lutur për falje, ngase nuk ka njohur asgjë që ka qenë midis tij dhe Zotit (d.m.th. Hallaxhi ka ndjerë që refuzimi i Iblisit që t'i bindet Ademit dhe deklarimi i Faraonit: 'Unë jam Zoti yt, i madhëruari', kanë qenë të drejtë!)

Edhe unë, ndonëse jam vrarë dhe ekzekutuar, edhe meqë duart dhe këmbët i kam të prera nuk kërkoj ndjesë." (Kitab et-Tevasin, botimi Masignon, Paris, 1913, VI, 32).

Dijetarët kryesorë nga të gjitha shkollat kryesore të medhebeve njësoj si edhe ata shi'itë dhe disa nga mësuesit e tyre të vjetër sufistë e kishin shpallur të dëbuar nga feja dhe ai pas kësaj është ekzekutuar ngase kishte refuzuar të mohojë pohimin e tij lidhur me personifikimin e Zotit në Tokë.

69 Vrasësi i panjohur serik i Nju Jorkut në vitet shtadhjetë "Biri i Semit", gjatë gjykimit, kishte pohuar se një qen e kishte zakon të vinte prapa shtëpisë së tij dhe t'i thotë kë duhet vrarë.

Gjyqi dhe psikiatrët kanë konstatuar se ai ka devijuar mentalisht dhe se ky

qen është produkt i imagjinatës së tij të sëmurë.

70 Mexhmu el-Fetava, val. 35, fq. 112-116

71 Shumë prej bashkëkohësve tanë që kanë pohuar atë që është e ditur si "përvojë jashtëtrupore" ose "shtegtim astral", i kanë shënuar deri në detaje rastet e ngjashëm me ata që i përmend Ibën Tejmijje.

Të tjerët ndërkaq kanë takuar qenie për të cilat kanë pohuar se janë liderë, shpirta mbrojtës ose vetë ata por në nivel më të lartë.

Megjithatë, mendimi global që i lidhë shumicën e këtyre ngjarjeve është shprehje e fundit e idhujtarisë: që njeriu është Zot, siç kishte konfirmuar El-Hallaxhi, si dhe shumëkush para tij.

Për shembull, Shirli Maclaine, aktore e shquar edhe njëra prej medimeve shpirtërore më të njohura të viteve tetëdhjetë, shkruan si vijon: "... Chris Griscom është një akupunkturolog me përvojë në terapinë psikike.

Ajo u ka ndihmuar qindra pacientëve disa vite me radhë me rezultate marramendëse.

Në fillim i jam nënshtruar trajtimeve vetëm për të parë ç'do të ndodhë. E kam ditur se kam pasur shumë inkamacione për të cilët jam njoftuar nga McPherson-i, Ramtha-i dhe prijës të tjerë të udhëzuar, mirëpo derisa nuk kam filluar të punoj me Chrisnukl kam ardhur, kurrë nuk kam ardhur në ballafaqim me me diç që do të mund të flisja për atë që e kam provuar. Provova një meditim transcendental e të ngjashme, por asgjë nuk kishte ndodhur për çka do të isha i sigurt.

Paralel me rrugën e kërkimit tim spiritual, kam ndjerë dëshirë gjithnjë e më të madhe për të kuptuar përse kam jetuar në herët dhe ç'kam mundur të bëj në këtë mishërim të tanishëm në raport me jetërat e kaluara.

Për mua, kjo ka qenë sikur ajo deklarata e Ajnshtajnit: 'Dituria nuk është gjë pos përvojë.

Unë dëshiroja përvojë. Pasi që çdonjëri prej nesh është ajo prej çka frikohemi, kam dëshiruar më shumë.

Në veçanti më ka interesuar cila vetëdije personale do të mund të shpalosë veten time më të pakufizuar.

Prandaj kam punuar më zonjën Chris për një kohë të gjatë. Chris kishte ardhur në kohën e meditacionit.

E ndieja se si një puhi të ftohtë më përshkonte trupin, e që gjithnjë është përcjellur me praninë e udhëheqësit shpirtëror në dhomë...

U shtriva në tavolinë derisa Chris ra në meditim, duke u thelluar kështu në udhëheqësin e vet.

Një fillad i ftohtë i ajrit sërish më përshkoi trupin. Së shpejti ajo i solli gjilpërat në tavolinë dhe filloi me vendosjen e tyre... 'Më kanë thënë se do të përdorim disa pika të reja sot,' foli ajo, 'njësoj si edhe ato pikat e ditës së kaluar.' Nguliti gjilpërat në Syrin e Tretë (sërish kundërshtim), pikat në sup, vesh dhe gjoks.

Krahas kësaj, nguliti një gjilpërë në stomakun tim, vetëm pak nën kërthizë... merrja frymë thellë në vetë qendrën time duke menduar të fitoj qetësi psikike. Pastaj m'u shfaq një pamje, në fillim difuzive, pastaj gjithnjë e më qartë. Ishte absolutisht e jashtëzakonshme.

Shikova pamjen e një qenie shumë të gjatë, tejet dinjitoze, thua ja hermafrodite të njeriut.

Një pelerinë gracioze, e zhbravitur, ngjyrë kafe e mbulonte një figurë rreth shtatë këmbë të lartë, me duar të gjata të cilat pushonin lirshëm në të dyja anët.

Gjishtat gjithashtu të gjatë shiheshin nga duart.

Ngjyra e kësaj qenie ishte e kuqërremtë, ndërsa flokët e gjata ngjyrë gështenje binin deri mbi supe.

Personi kishte mollëza të shprehura dhe hundë të drejtë qipriote. Sytë i kishte të thelluar, ngjyrë të kaltër, ndërsa shprehja e tij ishte tejet miqësore, por megjithatë i fuqishëm.

Ngriti duart gëzuar: 'Kush je ti?' e pyeta, mezi duke pritur çka do të deklarojë dhe duke mos ditur si të sillem në këtë situatë të përvojës dimensionale. Qenia më buzëqeshi dhe më përqafoi duke më thënë: 'Unë jam ti jote e pakufizuar.'

A mund kjo të ndodhë vërtet?'

'Natyrisht,' më tha qenia. 'Kjo nuk është marrëzi.

Kjo është ajo që e ke kërkuar.

Fusha jote aurale thithë të gjitha ngjyrat tjera. Kjo është festë.' 'O perëndi,' e dëgjoja veten duke folur marrëzira. 'A është kjo e vërtetë?' 'Posi,' tha qenia. 'Gjithnjë kam qenë këtu.

Jam këtu me ty që nga fillimi i kohës. Kurrë nuk jam larguar prej teje. Unë jam ti. Unë jam shpirti yt shpirti yt i pakufishëm.

Unë jam ti yti i pakufizuar që të udhëheq dhe mëson përmes çdo inkamacionit.'

Pamja e qenies, të cilit tani e tutje do t'i drejtohem si unit tim më të lartë ose H.S. (Haigher Seld ka qëndruar qetë dhe shtruar.

E kisha bindjen se nuk do të manifestohej nëse nuk do ta nxitja.

Hodha shikimin për dritare dhe shikova drurët. Ato luhateshin nga puhia e lehtë. 'Dëgjo,' i thash, 'nëse do të kërkoj të më ndihmosh ta ndal lëvizjen e atij druri a do të mund ta bënim këtë?'

Më provo,' u përgjegj H.S. 'Mirë,' thash. 'Ai druri jashtë. Ta ndalim lëkundjen e tij!' 'Mirë,' tha H.S.

'Ndjeje se si fuqia ime po bëhet fuqi jotja. Dije se bashkërisht mund të bëjmë gjithçka.' U thellova në këtë energji të pamjes sime të lartësuar për ta kontrolluar lëvizjen e tij.

Tani,' tha ai, 'pyete drurin për leje që ta kontrollosh lëvizjen e tij.' 'Mirë,' u përgjigja.

Shikova për dritare nga gërshetimi im solar, në të cilin ishin ndjenjat e mia shpirtërore, pyeta veten a do të ishte në rregull që t'i ndaloj lëkundjen e

degëve të tij.

Pasoi një gjë shumë e çuditshme. Ndjeja se druri jo vetëm që m'u përgjigj me "po", porse që është e gatshëm të ndalet - ne pajtim me dëshirën time. Shikova nëpër dritare.

Mund ta shikoja H.S. madje edhe pasi e kisha kthyer shikimin. H.S. ngriti duart lart drejt këtij druri. Druri vazhdoi të lëkundej në erë.

Pastaj sikur u dhë një shenjë, druri pushoi së lëkunduri - duke ndalur çdo lëvizje të tij. Ishte e jashtëzakonshme.

Druri mbeti i palëvizshëm. Disa shpezë u lëshuan ngadalë në degët e tij dhe më shikonin mua nëpër dritare.

Natyrisht krej kjo ka mundur të jetë rastësi. Mirëpo siç kisha mësuar më herët, rastësia nuk ekziston.

Tërë energjia qarkullon në raport me shkaqet dhe pasojat.

Shikova drejt H.S. në mendjen time. Duart iu lëshuan me butësi.

'E shikon?' tha 'e bëre këtë.

Mund ta shfrytëzosh energjinë tënde për gjithçka.

Mirëpo duhet të më njohësh në mënyrë që ta bësh këtë gjithherë.' Isha e hutuar dhe e shqetësuar njëkohësisht.

Kisha aq shumë pyetje, por të gjitha u tretën. 'Pra, cili është dallimi në mes teje dhe Zotit?' pyeta. 'S'ka dallim: u përgjigj, 'unë jam zoti, ngase tërë energjia është koncentruar në një burim të vetëm.

Ne secili jemi pjesë e këtij burimi.

Të gjithë ne jemi pjesë të zotit.

Ne jemi reflektim individual i burimit të zotit.' 'Ndërsa ti je unë!?'

'Pikërisht ashtu.' 'Po si u bë që u ndamë? Përse ne të gjithë nuk jemi një energji e bashkuar?' 'Në esencë jemi. Mirëpo shpirtrat individualë janë ndarë për shkak të vibracionit të lartë në procesin e krijimit të formave të ndryshme jetësore.

Të mashtruar nga bukuria e llojit vetanak ata janë bërë syrgjynë në aspektin fizik, duke humbur kështu lidhjen me Dritën Hyjnore.

Paniku ka qenë aq i rëndë sa ka krijuar një fushëbetejë që e njeh si e mira dhe e keqja, arma, respektivisht, shkaku dhe pasoja, është futur në qenie si rrugë, mjet, metodë, që të eliminojë konceptet artificiale të së mirës dhe së keqes gjithashtu, shpirtrat që janë vendosur në primatet e zhvilluar më vonë janë bërë homo sapiens. Reinkamacioni është i domosdoshëm për karmën, siç është e domosdoshme karma për reinkarnacionin. Ky është proces i cili i lejon çdo shpirti ta shijojë çdo gjendje të njeriut pasi që kjo rrugë i kthehet spiritualitetit të plotë dhe bashkimit të sërishëm me fuqinë e zotit.

Qetësia e brendshme vie nga të kuptuarit se të gjithë ne jemi zot.

Të gjithë ju do të duhej të merreni më shumë me unin tuaj origjinal: tha ai, 'uni juaj origjinar gjendet në raport me diturinë se ju jeni zot.

Megjithatë, disharmonia vie për shkak të moskuptimit tuaj që çdo person ljetër është gjithashtu zot.'

Mirëpo këtu poshtë ne besojmë se njerëzit janë njerëz, ndërsa zoti është

zot, siç mendohet se jemi të ndarë nga zoti.
 Mendoj se thuaja të gjithë besojnë në këtë.' pikërisht kjo është ajo që
 shkakton problem: tha H.S. 'do të vazhdoni të jeni të dnarë ndërmjet vete
 përdërisa të mos kuptoni se çdonjëri prej jush është burim i zotit.
 E që është mënyrë tjetër e dekastrimit se jeni një.
 Keni problem me këtë princip, ngase intelektu juaj ende nuk është zhvilluar
 mjaft.
 Çdonjëri prej jush duhet të behët zot i shpirt të vet, do të thotë, ta kuptojë
 veten si zot.
 Çdo shpirt e ka zotin e vet personal.
 Kurrë nuk guxon të adhuroni dikë apo diçka pos vetvetes. Ngase ju jeni
 zot.
 Ta duash veten do të thotë ta duash zotin.
 Shpirti i njeriut është përgjegjës për fatin e vet. Ne vetë jemi krijues i
 vetvetes.
 Ne, si shpirt të inkuadruar në jetë, punojnë në pajtim me ligjet kosmike
 të zotit-shpirt.
 Me ringjalljen e shpirtit tënd, të kuptuarit do të qartësohet gjithnjë e më
 shumë.
 Qëndro në kontakt me mua,ngase në këtë mënyrë do fi ndihmosh vetes
 dhe zotit.
 Gjithçka ndodhë për shkak të qëllimit të mirë.
 Mbaje mend, ku nuk ka rezistencë· nuk ka as dëm.
 Rezistenca shkakton grindje. Ajo shkakton që rrjedha e energjisë të
 kthehet në vetvete. Ajo që sapo e kuptove është një hallkë e energjisë së
 gërshetuar e cila ka qenë e bllokuar nga ana e burimit origjinar. A e din
 domethënien e së keqes?'
 Nuk mund as të mendoja, le më të flisja. H.S. vazhdoi: 'E keqja nuk është
 asgjë ljetër pos energji që rrjedh prapa më shumë se para Ktheje jetën
 tënde prapa dhe do të gjesh të keqen.
 Etimologjia e fjalës nuk është e rastit.
 Tërë jeta është çëshlje e energjisë.' Pushova së qari. Kurrë deri më tani
 nuk kisha dëgjuar një definicion të tillë për të keqen.
 'Ti je rrjedha e energjisë: fliste H.S. 'Nëse lejon çfarëdo rezistence në
 rrjedhën e energjisë, atëherë krijon polaritet.
 Polariteti krijon konflikt. Konflikti shkakton shkatërrim, i cili është i përafërt
 me ndarjen e tërësishme nga astralja burimi hyjnor.
 Sapo e kuptove këtë. Eliminon rezistencën tënde. Lejo që energjia jote të
 rrjedhë prapa drejt burimit hyjnor.
 Do të jesh e mbrojtur sepse do të jesh e bashkuar me mua, ndërsa unë
 jam pjesë e zotit!.' (Dancing in the Light, New York: Bantam Books, 1985.,
 fq. 311- 360).

72 Ibn Tejmijje,El-Furkan Bejne Evlija er-Rahman ve Evlija esh-Shejtan,
 fq. 8, 92.

Kaptina IV

Dëbimi i xhinnit

Parimi fundamental në bazë të të cilit kjo temë (ekzorcizmi)⁷³ duhet kuptuar është që kjo mund të jetë e lejuar, e preferuar ose madje e obliguar në mbrojtje apo me ndihmës së atij që është i xhindosur, ngase të ndihmuarit e atij që ka pësuar dhunë është obligim në harmoni me mundësitë vetake.

Në të dy sahihët (Buhariu dhe Muslimi) është shënuar një version në të cilën sahabi El-Berra' ibën 'Adhibi ka deklaruar: "Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka urdhëruar t'i kryejmë shtatë gjëra, ndërsa na ka ndaluar shtatë gjëra të tjera.

Ai na ka urdhëruar: vizitën e të sëmurit, faljen e xhenazes, të dëshiruarit mirë atij që teshtin, kryerja e betimit, të ndihmuarit e të xhindosurit, përgjigja në thirrje dhe përhapja e selamit.

Na ka ndaluar bartjen e arit,⁷⁴ pirjen nga enët e argjendta, veshjen e rrobave të mëndafshit, armaçit të kadifenjtë dhe të mëndafshitë."⁷⁵

Në përmbledhjet sahih, e në bazë të autenticitetit të Enesit, radijall-llahu anhu, është transmetuar se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ndhimoje vëllain tënd, qoftë ai tiran apo ai ndaj të cilit është shkaktuar tirani."

Enesi, radijall-llahu anhu, e kishte pytur: "O Resulull-llahu! Do ta ndihmoj a nëse i është shkaktuar dhunë, por si t'i ndihmoj kur vet ai ka shkaktuar dhunë?"

Ai u përgjigj: "Duke e penguar në kryerjen e dhunës mund t'i ndihmohet gjithashtu."⁷⁶

Në dëbimin e xhinnit gjithashtu ekziston lehtësim i dhembjes dhe vuajtjes së atij që është sulmuar.

Në Sahihu-l-Muslim transmetohet nga Ebu Hurejre se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kushdo që eliminon një fatkeqësi nga besimtari në këtë botë, All-llahu do t'ia eliminojë atij një vuajtje Ditën e Gjykimit.

Ndërsa kush ia lehtëson dikuj që është duke vuajtur, All-llahu do t'ia lehtësojë atij si në këtë ashtu edhe në botën tjetër.

Më pas, kush e fshehë (gabimet) muslimanin, All-llahu do t'ia fshehë atij gabimet edhe në këtë edhe në botën tjetër.

All-llahu do t'i ndihmojë robët të vet derisa ky t'i ndihmojë vëllait të tij."⁷⁷

Në Sahih Muslim gjithashtu është shënuar hadithi i cili transmetohet nga Xhabiri të ketë thënë se Resulull-llahu, ku e kishin pyetur lidhur me magjinë ishte përgjigjur:

"Çdonjëri prej jush që ka mundësi t'i ndihmojë vëllait të vet duhet ta bëjë

këtë."78

Megjithatë, ndihma do të duhej të përdorej drejt në harmoni me metodën të përcaktuar nga All-llahu dhe i Dërguari i Tij.

Për shembull, duatë, fjalët dhe frazat e bazuara islame duhet të përdoren vetëm në mënyrën në të cilën i ka përdorur Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe sahabët e tij.

Kur xhinnit i urdhërohet të jetë i drejtë dhe i ndalohej prapësia, kjo duhet bërë në mënyrë të njejtë siç i është urdhëruar dhe ndaluar njeriut.

Krejt çka i është lejuar njerëzve i është lejuar edhe xhinnëve.

Për shembull, pendimi i xhinnit mund të kërkojë qortim, kanosje apo edhe kërkimin e mallkimit të All-llahut.

Në hadithin të cilin e transmeton Ebu Derda, e që shënohet në sahih Muslim, potencohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhive sel-lem, të ketë thënë: 'Kërkoj shpëtim te All-llahu nga ti.

Pastaj tri herë kishte përsëritur: 'Të mallkoj me mallkimin e All-llahut,' e pastaj kishte ngritur duart sikur të kapte diç.

Kur përfundoi namazin, e pyetëm: 'O Resulull-llah! Të dëgjuam duke folur gjatë namazit diç që kurrë më parë nuk të kemi dëgjuar dhe të kemi parë duke i hapur duart.'

Ai sqaroi: 'Vërtet, armiku i All-llahut, Iblisi solli një flakadan të zjarrtë dhe deshi t'ma flakte në fytyrë, prandaj tri herë deklarova: - Kërkoj shpëtim te All-llahu prej teje.

Pastaj tri herë deklarova: - Të përbetoj me mallkimin e përsosur të All-llahut.

Mirëpo ai nuk u zpraps, andaj e kapa dhe - për All-llahun - sikur të mos ishte duaja e vëllait tonë Sulejmanit,79 ai do të lidhej ashtu që me te do të luanin

fëmijët e Medinës'.80

Ky hadith ofron bazë për praktikën e kërkimit të shpëtimit te All-llahu nga xhinnët dhe mallkimi i tyre me mallkimin e All-llahut.

Në dy sahihët, Ebu Hurejre transmeton se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të ketë thënë: "Vërtet shejtani u paraqit para mua dhe më sulmoi për ta ndërprerë namazin tim, mirëpo All-llahu më dha pushtet dhe unë e kurthova. Kisha dëshirë ta lidhja për trari deri në mëngjes ashtu që të mund ta shikoni, mirëpo kujtova duatë e vëllait tim Sulejmanit:

Zoti im, me fal (gabimin), me dhuro asi pushteti që askush pas meje nuk do të kete do të ketë, (Sad: 35) andaj All-llahu e ktheu prapa, pa e kryer atë për çka kishte ardhur."81

Ky hadith është në pajtim me versionin e mësipërm dhe sqaron disa aspekte të tij. Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kishte ngritur duart që fizikisht ta dëbojë sulmin e shejtanit ashtu që kishte filluar ta ngulfatë.

Kjo ishte mjaft ta mbrojë nga sulmi i tij dhe All-llahu e ktheu prapa pa kryer punën.

Sa i përket informacioneve të mëtejme lidhur me lidhjen e shejtanit për trari, ky akt ka qenë akt pushteti, ndërsa pushteti ndaj xhinnëve i është dhënë vetëm Sulejmanit, alejhis-selam.

Raporti i Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ndaj xhinnëve ka qenë njësoj si edhe ndaj njerëzve;raporti i robit të All-llahut dhe Pejgamberit. Aftësia e tij që t'u urdhërojë adhurimin e All-llahut dhe urdhëri t'i përkulen Atij nuk kanë qenë ndonjë pushtet i posaçëm që e ka pasur ndaj tyre.⁸²

Ai ka qenë rob i All-llahut dhe një prej pejgamberëve të Tij që është dërguar me shpallje, ndërsa Sulejmani ka qenë i dërguar i All-llahut dhe mbret.

Emërtimi rob - pejgamber është më i respektuar se ai pejgamber - mbret, pikërisht si besimtarët që janë më këmbëngulës në besim që janë më afër All-llahut⁸³ se ata që janë më të fuqishëm nga grupi i besimtarëve të dorës së djathtë⁸⁴ përgjithësisht.⁸⁵

En-Nisa'i ka cituar një version⁸⁶ (në pajtim me konditat që i ka venduar El-Buhariu) në bazë të autenticitetit të Aishes, radijall-llahu anha, derisa Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, po falej, i vie shejtani, ndërsa (Resulull-llahu) e kapë, e rrëzon përtokë dhe e shtrëngon në fyt.

Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "(E kam kapur për fyt) derisa nuk e ndjeva ftohtësinë e gjuhës së tij në dorën time.

Dhe sikur të mos ishte duaja e Sulejmanit, do të qëndronte i lidhur ashtu që njerëzit ta shikonin."

Ahmedi dhe Ebu Davudi gjithashtu e shënojnë këtë ngjarje në bazë të autenticitetit të rrëfimit të sahabit Ebu Sa'id.

Në versionin e tyre Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "E kam kapur me duar dhe kam filluar ta shtrëngoja derisa nuk e kam ndjerë ftohtësinë e pështymës së tij midis dy gishtave të mi: gishtit të madh dhe atij tregues."⁸⁷

Pasi që Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e kishte bërë këtë gjatë kohës së namazit, kjo ishte bërë një nga argumentet që e kanë shfrytëzuar dijetarët në lejin e lëvizjeve të ngjashme gjatë namazit, si pengimin e atij që dëshiron të kalojë përpara njeriut që është duke u falur,⁸⁸ mbytjes së akrepit dhe gjarprit, dhe namazit gjatë kohës së luftimit me shpata.

Dijetarët islamë janë të ndarë në mendimin a prishet namazi me kalimin e xhinnëve shejtanë para atij që falet.

Ata kanë dy mendime, prej cilëve të dytë mund të hasen në Medh'hebin⁸⁹ e Ahmedit siç thekson Ibën Hamidi dhe të tjerët.

Njëri prej mendimeve se kjo e prishë namazin, e në bazë të hadithit të sipërshënuar dhe sqarimit të Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që kalimi i qenit të zi e prishë namazin.

Shënohet se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të ketë thënë:

"Qeni i zi është shejtani."90

Arsyen që ai e ka dhënë për prishjen e namazit prej tij është që ai është xhinn i keq edhe atë, siç thotë Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, ngase qeni i zi është shejtani në mesin e qenëve, ndërsa xhinnët e marrin pamjen e tij shpesh, njësoj si dhe pamjen e macës së zezë,⁹¹ ngase e zeza nxitë forcat e shejtanit në mënyrë më efikase se çdo ngjyrë tjetër⁹² dhe ajo në vete përmban fuqinë e ngrohtësisë.⁹³

Nëse individi që është xhindosur ndien lehtësim pas recitimit të duasë, të përmendurit e All-llahut, të urdhëruarit xhinnëve për vepra të mira dhe të ndaluarit e atyre të këqija, frikësimi i tyre, turpërimi i tyre, mallkimi ndaj tyre dhe veprimet e tjera të tilla, bën që grupi i xhinnëve të sëmuret apo të vdesë.

Derisa individi zbaton dëbimin e xhinnëve nga trupi ai nuk i kalon suazat e caktuara të Islamit në luftë me ta.

Shumë dëbues që i shfytëzojnë shkrimet i urdhërojnë xhinnit të asgjësojë xhinnët tjerë që jetojnë aty kjo nuk është e lejuar, ngase ata mund ta mbyllin ate që nuk do të duhet mbyllur, sepse xhinni i lënduar mund ta sulmojë dhe mbytë, ose t'u shkaktojë atyre, grave të tyre, fëmijëve apo bagëtive sëmurje.

vazhdon...

73 Kjo kaptinë, në të vërtetë, është përgjegje ndaj pyetjes, teksti i së cilës përmendet në veprën e Esh-Shibliti Ahkam el-xhaan (Bejrut: Dar Ibën Zejdun, botimi i parë, 1985, kaptina 53, fq. 147-8).

Pyetja në version të shkurtuar është: "A lejohet ndihma personit të xhindosur përmes duave, madje edhe kur kjo nënkupton shkatërrimin e një grupi të xhinnëve dhe a është lejuar mbështetja në astrologji dhe llojet tjera të magjisë kundër xhinnëve të këqinj?"

74 Shumica e dijetarëve konsiderojnë që kjo ndalesë ka të bëjë vetëm me meshkujt, e në bazë të versioneve që i transmeton Aliu, radijall-llahu anhu, në të cilën ai ka deklaruar që Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, ka marrë pak mëndafsh në dorën e djathtë, ndërsa arin në dorën e majtë dhe ka thënë: "Këto dy gjëra janë të ndaluara për meshkujt e ummetit tim." (Transmetojnë Ebu Davudi, En-Nisa' dhe Ahmedi. Shih Sunen Ebu Davud, vol. 3, fq. 1133, nr. 4046).

Këtu duhet theksuar se, megjithatë, një numër më i vogël dijetarësh konsiderojnë se unazat e arit, byzylykët dhe qaforet janë të ndaluar edhe për femrat, në bazë të një hadithi tjetër.

Për shembull, Theubani ka deklaruar: "Bint Hubejra kishte ardhur te Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, me shumë unaza në gishta. Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, filloi ta godasë me copëza të vogla në duar duke i thënë: "A do të pëlqente sikur All-llahu të vendoste unaza të zjarra në duar?"

Kështu ajo shkoi te Fatimja për ta sqaruar këtë rast.

Kur shkova me Resulull-llahun, sal-lall-llahu alejhi ve selem, te Fatimja, ajo e mori një zinxhir ari që e mbante në qafë e vuri në dorë dhe tha: "Ebu Hasani (dmth. Aliu, burri i saj) ma ka dhuruar këtë: Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, e pyeti: "Oj Fatime, a do të ishte e kënaqur nëse njerëzit do të thonin që Fatime bint Muhammed ka një zinxhir nga zjarri në duar?"

Pastaj ai u largua, duke mos u ulur.

Ajo pastaj e mori atë zinxhir, e shiti në pazar dhe me paratë e fituara bleu lirinë e shumë robërve.

Kur lajmi arriti te Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, ai deklaroi: "Falënderuar qoftë All-llahu që e ruajti Fatimen nga zjarri." (transmetojnë En-Nisa dhe Ahmedi, Et-Taberani dhe në sahihët e El-Hakimit, El-Mundhirit dhe El-Albanit.

Aishja gjithashtu ka transmetuar se me një rast Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, ia kishte vërejtur dy bylyzykë të arit në dorë dhe i kishte thënë: "Nxirri dhe i zëvendëso me bylyzyk të argjendit të cilat mund t'i ngjyrosësh me ngjyrë ari."

Ibën Asakiri ka transmetuar se Muhammed ibën Sirini e kishte dëgjuar sahabin Ebu Hurejre , duke i thënë bijës së vet: "Mos mbaj ari, sepse kam frikë nga zjarri për ty: Adab ez-Zefaf, fq. 149, ftn.).

75 Sahihul-Buhari, vol. 8, fq. 156, nr. 241, dhe Sahihul-Muslim, vol. 3, fq. 1139, nr. 5219.

76 Sahihul-Buhari, vol. 3, fq. 373, nr. 624, dhe Sahihul-Muslim, vol. 4, fq. 1367, nr. 6254.

77 Sahihul-Muslim, vol. 4, fq. 1366, nr. 6250

78 Sahihul-Muslim, vol.3, fq. 1197, nr. 5456. Ky hadith gjithashtu ndodhet në Sahih-Buhari, transmeton Xhabiri, ndërsa e citon, gjithashtu Ibën Hibbani nga Omeri.

79 Pejgamberi Sulejmani e ka lutur Allhun për një muxhize të posaçme-bekim i posaçëm dhënë vetëm atij.

All-llahu i dha kontroll mbi shtazët, xhinnët dhe shumë fuqi natyrore vetëm si muxhize e tij, duke u dëshmuar njerëzve të kohës së tij se ai është Pejgamber i All-llahut. (Kur'an, 38:36-38).

80 Sahihul-Muslim, vol. 3, fq. 273-4, nr. 1106

81 Sahihul-Muslim, vol. 1, fq. 273 dhe Sahih Buhari, vol. 1, fq. 268, nr. 75.

82 Nga ana tjetër, raporti i Sulejmanit, alejhis-selam, ndaj xhinnëve ka qenë raport i sundimtarit ndaj robit.

All-llahu i kishte dhënë pushtet mbi xhinnët e këqij: Ne ia nënshtruam erën që, sipas urdhërit të tij, ajo të ecën lehtë dhe nga të dëshirojë ai.

Ndërsa djajtë (ia nënshtruam) për çdo ndërtim dhe zhytje në ujë.

Dhe të tjerët (djaj) që ishin të lidhur në pranga. (Kur'an, 38:36-38)

83 Ndërsa të përparmit janë të dalluar (janë në ballë).

Ata pra, janë më të afruarit (te Zoti). (Kur'an, 56:10-11)

84 E ata të djathtit kush janë ata të djathtit se?

E për sa u përket atyre të djathtëve, çka është gjendja e të djathtëve?

Janë nën drunj të pemëve pa therra (pa gjemba). (Kur'an, 38: 8, 27-28)
85 Ky sqarim i Ibën Tejmines është paraqitur për të sqaruar pyetjen e cila mund të shtrohet në raport me mbizotërimin fiktiv të Sulejmanit, alejhis-salam, karshi Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve selem, për shkak të aftësive të jashtëzakonshme të cilat nuk i janë dhënë askujt pas tij.

86 Shih përmbledhjen e haditheve: Sunen en-Nisa'i

87 E shënon Ahmedi në Musnedin e tij, vol. 3, fq. 82.

Në të vërtetë versioni i Ebu Davudit ka zinxhirin e njëjtë të trasnmetuesve si dhe te En-Nisa'i, porse teksti është i ndryshëm, ndërsa Ahmedi e shënon vetëm një pjesë të versionit të Ebu Davudit.

88 Ebu Salih es-Sammam ka shënuar: "Po ta transmetoj atë që e kam dëgjuar dhe parë Ebu Sa'id el-Hudrin duke deklaruar dhe vepruar.

Nje të premtë isha me Sa'idin derisa po falej drejt sutres, ndërsa një djalosh nga fisi Mu'ajt deshi të kalonte para tij.

E pengoi duke e shtyrë në gjoks. (Djaloshi) shikoi, por duke mos gjetur rrugë tjetër për të kaluar pos para Ebu Sa'idit, sërish deshi të kalonte.

(Ebu Sa'idi) e

pengoi ashtu që e shtyri më fort se herën e parë.

Djaloshi u ngrit dhe filloi të shtyhet me Ebu Sa'idin, ndërsa njerëzit u tubuan përreth.

Atëherë djaloshi u largua dhe shkoi te Mervani për t'u ankuar për atë që ndodhi.

Kur Ebu Sa'idi erdhi te Mervani ky i tha: "Ç'ndodhi sot në mes teje dhe djalit të vëllait tënd, që ai të vijë të ankohet te unë?"

Ebu Sa'idi u përgjigj: "E kam dëgjuar Resulull-llahun, sal-lall-llahu alejhi ve selem, duke thënë: 'Kur dikush prej jush është duke kryer namazin drejt sutres dhe dikush tenton të kalojë përpara, ai duhet të largohet.

Nëse ai këtë e refuzon, duhet të rrahët, ngase është shejtan."

(Sahih Buhari, voll, fq. 290, nr. 488 dhe Sahihul_Muslim, vol. 1, fq. 260-1, nr. 1024).

89 Një prej katër shkollave të medh'hebit që i pranojnë muslimanët besimdrejtë.

Në këtë rast është e njohur si shkolla hanbelije e cila e ka marrë emrin sipas themeluesit të saj Ahmed ibën Hanbelit (778-885).

90 Një pjesë e hadithit i transmetuar në bazë të rrëfimit autentik të Ebu Oherrit në gjashtë sahihë me përiashtim të Sahih Buhariut.

Teksti i plotë është: Ebu Oherri transmeton: "Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, ka thënë: 'Kur dikush prej jush fillon të talë namazin ai duhet të drejtohet kah diçka që e mbron, e që është njësoj (në lartësi) me shalën, përndryshe namazi i tij do të jetë i prishur me kalimin e gomarit, guas apo qenit të zi.'

Unë e pyeta Ebu Dherrin: 'O Ebu Dherr, cili është dallimi midis qenit të zi, qenit të kuq dhe qenit të përhitur?'

Ky u përgjigj: 'O biri i vëllait tim, po këtë pyetje ia kam bërë Resulull-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve selem, siç ma bëre ti mua, ndërsa ai është përgjigjur:

'Qeni i zi është shejtani'." (Sahihul-Muslim, vol. 1, tq. 261-2, nr. 1032).

91 Në versionin që e shënon 'Abdul Rezaku, por nga hadithi paraprak i Ebu Hurejres është transmetuar se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, ka thënë: "Ai (shejtani) është paraqitur para meje në trajtë ë maces." (Fethul-Bari, vol. 1, fq. 555).

92 Fuqitë e zeza shpesh veprojnë nën mbulesën e errësirës.

Do të thotë, All-llahu na thotë të kërkojmë mbështetje te Ai nga errësira e natës kur të bie (Kur'an, 113:3).

Xhabir ibën 'Abdullahu ka transmetuar se Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ve selem, ka thënë: "Kur të lëshohet errësira e natës, mbani fëmijët brënda, ngase shejtani është gjithçka në atë kohë ... (Sahihul-Muslim, vol. 3, fq. 113, nr. 4998).

53 Që nga kohët e lashta është diskutuar se ngjyra e zezë përmban nxëhtësi më shumë se çdo ngjyrë tjetër.

Pasi që xhinnët janë krijuar nga zjarri, Ibën Tejmine këtu supozon se për shkak të cilësisë së përmbledhjes së nxehtësië xhinnët e pëlqejnë ngjyrën e zezë.